

Shtigje Pelegrinazhi dhe Pelegrinazhe në Greqi dhe Shqipëri

Promovimi dhe shfrytëzimi
të trashëgimisë kulturore





Shtigje Pelegrinazhi dhe Pelegrinazhe në Greqi dhe Shqipëri

Promovimi dhe shfrytëzimi
të trashëgimisë kulturore

Autorët

Eleni Michou, Arkeologu
Andi Rembeçi, Pedagog i Historisë Bizantine dhe Paleografisë Greke
Orfea Beçi, Gazetari - Analist

Lektorimi

Georgios D. Kapsalis, Profesor - ish-Rektor i Universitetit të Janinës
Christina Matiaki, Historian Arti / Teologu - Bizantinolog

Dizajni

MAKAN





Pro log

Parathënie për projektin PROFORA



Bashkëpunimi mes popujve fqinjë çon në rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe krijimin e kushteve për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm kulturor, intelektual dhe ekonomik. Bashkëpunimi ndërkufitar midis Greqisë dhe Shqipërisë paraqet një veçori të shtuar, pasi ekzistenca e minoritetit grek në Shqipëri është një lidhje e fortë komunikimi dhe mirëkuptimi mes dy popujve.

Një tjetër element, me rëndësi dhe peshë të veçantë, është objekti që ka në fokus ky bashkëpunim. Qëllimi i tij kryesor është të evidentojë pikat dhe shtigjet e rëndësishme të pelegrinazhit, të cilat ndodhen në zonën ndërkufitare të të dy vendeve dhe janë me interes të madh historik e fetar. Për rrjedhojë, nëpërmjet prezantimit dhe promovimit të objekteve të kultit, synojmë të nxisim zhvillimin e turizmit fetar në këtë zonë. Një element kyç i këtij projekti është njohja dhe promovimi i vazhdimësisë historike e kulturore që karakterizon vendet specifike të kultit. Në të njëjtën kohë, kërkojmë të forcojmë dhe përmirësojmë të gjitha kushtet që do të kontribuojnë në zhvillimin e organizuar ekonomik të zonave të përzgjedhura brenda hapësirës së zbatimit të projektit.

Sigurisht që zbatimi i projektit do të kryhet me shfrytëzimin paralel të mundësive të ofruara nga Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit.

Zona e zbatimit të projektit përfshin, për palën greke, Mitropolinë e Shenjtë të Janinës dhe, për palën shqiptare, kufijtë administrativë të Bashkisë së Gjirokastrës, Mitropolinë e Shenjtë të Gjirokastrës dhe Mitropolinë e Shenjtë të Korçës.

Për digjitalizimin dhe vënien në dispozicion të informacionit përkatës online, në zonat e zbatimit të projektit janë regjistruar, vlerësuar dhe dokumentuar nga ana shkencore monumentet e kultit, që shquhen për vlerat dhe rëndësinë historike e kulturore. Kjo u arrit përmes një portali informues në internet, të krijuar posaçërisht. Përveç shtigjeve të paracaktuara, të cilat shfaqin interes të veçantë tematik, kemi projektuar edhe shtigje alternative turistike, për të cilat vizitori informohet në varësi të vendndodhjes gjeografike, duke pasur vetë ai mundësinë të vizitojë monumentet fqinje.

Kemi krijuar tri Qendra për Informimin dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore e Fetare: në Janinë, Gjirokastrë dhe Korçë. Këto qendra ofrojnë informacione dhe materiale promovuese për monumentet më të rëndësishme fetare të zonës, për shtigjet e propozuara të pelegrinazhit, si dhe për bizneset turistike të zonës. "Pulla dalluese e cilësisë", që është vendosur në të gjitha ndërmarrjet turistike që plotësojnë kriteret e veçanta të cilësisë, është pikë referimi dhe garancie për të gjithë turistët pjesëmarrës në shtigjet e pelegrinazhit.

Gjithashtu, kemi ndërmarrë një sërë veprimesh plotësuese që kontribuojnë në mënyrë vendimtare në përmirësimin e mëtejshëm dhe maksimizimin e rezultateve të zbatimit të përgjithshëm të projektit, ndërkohë që studimi për vlerësimin e rezultateve të projektit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së tij janë prioritetet kryesore. Portali disagjuhësh Kulturor dhe Turistik (greqisht, shqip, anglisht), si dhe aplikacioni i posaçëm për pajisjet celulare, i ofrojnë vizitorit mundësinë e qasjes në materiale të përpunuara posaçërisht për ofrimin e informacionit me rëndësi fetare, historike dhe arkitekturore. Funkzionimi i tri Qendrave ndërkufitare për Informimin dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore e Fetare në Janinë, Gjirokastrë dhe Korçë do të luajë rol kyç në promovimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe aktivitetet për promovimin e projektit dhe të rezultateve të tij, me krijimin dhe shpërndarjen e materialit informues, dhe, mbi të gjitha, me botimin e këtij vëllimi në greqisht, shqip dhe anglisht. Përveç promovimit të përgjithshëm të projektit dhe vlerësimit në tërësi të tij, shqetësimi kryesor i të gjithëve është sigurimi i realizueshmërisë së tij.

Universiteti i Janinës, si koordinatori i projektit, si dhe të gjithë partnerët, Prefektura e Epirit, me interesimin personal të Prefektit të saj, z. Aleksandros Kahrmanis; Mitropolia e Shenjtë e Janinës dhe vëmendja e kujdesi i vazhdueshëm atëror i Mitropolitit të saj, Hirësi Maksimit; interesimi i vazhdueshëm dhe dashuria e bujaria e Mitropolitit të Gjirokastrës, Hirësi Dhimitrit; dashamirësia dhe vlerësimi i Mitropolitit të Korçës, Hirësi Joanit, kontribuan në finalizimin e suksesshëm të kësaj përpjekjeje të përbashkët, e cila u vlerësua nga të gjithë pjesëmarrësit.

Do të kem rastin të falënderoj personalisht secilin prej pjesëmarrësve në këtë rrugëtim interesant të përtëritjes shpirtërore, të dijes dhe të kulturës. Në këtë pikë, dëshiroj të falënderoj përzemërsisht Zëvendësdrejtnesin Shkencor të Projektit, Profesor Anastasios Embalotis, për kontributin e tij të rëndësishëm në zbatimin e Projektit dhe atmosferën e shkëlqyer të bashkëpunimit dhe bashkudhëtimit që kemi krijuar.

Të gjithë pjesëmarrësit në Projekt punuan me frymë reciprociteti e solidariteti. Për shkak të pandemisë, u detyruam ta zbatonim në një kohë veçanërisht të vështirë. Megjithatë, besuam në rëndësinë e madhe të Projektit dhe synimet e larta që vendosëm. Gjykoj se kemi arritur me siguri një rezultat të lavdërueshëm, i cili duhet të ketë vazhdimësi dhe perspektivë. Mirënjohja ime personale për të gjithë ata që morën pjesë në zbatimin e Projektit është e pakufishme, e qëndrueshme dhe e paçmueshme.

Përgjegjësi Shkencor i Projektit

Prof. Georgios D. Kapsalis

Profesor, ish-Rektor i Universitetit të Janinës

Fjalë përshëndetëse për projektin PROSFORA



Në një kohë kur nevojiten "shtigje" të reja zhvillimi për të dalë nga kriza e përgjithshme ekonomike, Prefektura e Epirit synon të shfrytëzojë sa më shumë burimet e projekteve të bashkëpunimit territorial evropian INTERREG. Në këtë kuadër bën pjesë edhe pjesëmarrja e saj në projektin PROSFORA, i cili, nëpërmjet prezantimit dhe promovimit të monumenteve të zgjedhura të kultit, synon të stimulojë ekonominë vendase dhe të çlirojë turizmin fetar.

Këtij qëllimi i shërben edhe botimi i rëndësishëm "Shtigje pelegrinazhi dhe pelegrinazhe në Greqi e Shqipëri", i cili paraqet vendet më të rëndësishme të lutjes dhe shtigjet e pelegrinazhit të zonës ndërkufitare të Prefekturës së Epirit dhe Shqipërisë.

Bëhet fjalë për monumente dhe shtigje, të cilat janë pika referimi për të gjithë botën e krishterë orthodhokse. Monumente me jetë shekullore, secili me arkitekturën dhe historinë e tij, krijime të mjeshtërve të artit dhe me afreske unike. Manastiret – simbole të transhendentës – disa të "varura" në shkëmbinjtë e thepisur mbi gryka, të tjera të ndërtuara në tempuj dhe faltore të lashta. Pothuajse të gjitha kanë një arkitekturë unike fortifikimi, që të kujton kështjellat, vendstrehimet e izoluar të mbijetesës dhe mbrojtjes.

Kishat qendrore, bibliotekat dhe muzetë e manastireve ruajnë afreske, ikona lëvizëse, dorëshkrime, libra dhe trashëgimi me vlera të pallogaritshme historike e kulturore.

Botimi që mbani në duar, është produkt i projektit evropian PROSFORA. U vjen në ndihmë të gjithë atyre që dëshirojnë të njohin shtigjet unike të pelegrinazhit në vijën kufitare Greqi-Shqipëri. Botimi është një kontakt i parë njohjeje, e cila do të pasurohet më pas nga vizitat në monumente, nga përjetimi i çasteve të paqes, nga njohja me historinë dhe nga admirimi i arkitekturës së tyre.

Për Prefekturën e Epirit, zhvillimi i turizmit fetar dhe pelegrinazhit është një nga prioritetet kryesore, ku zbatimi i projektit PROSFORA kontribuon padyshim.

Kryetari i Prefekturës së Epirit
Alexandros Kachrimanis



Parathënie e Mitropolitit të Janinës, Hirësi Maksimit

Sa herë që na jepet mundësia për të bashkëpunuar me njerëz nga vende të tjera, jashtë kufijve të ngushtë të juridiksionit tonë, sa herë që ndërveprimi me kryepiftërinj të tjerë, shkencëtarë, teknologë të specializuar merr mish e gjak, pra paraqet rezultate të prekshme, është një mundësi për të rizbuluar rëndësinë e pasurisë së dhuntive, dinamikën që sinergjitë i japin përditshmërisë sonë dhe gjurmës që ato lënë në mjedisin ku jetojmë.

Një mundësi e tillë ishte veprimtaria dhe partneriteti ndërkufitar kërkimor, në të cilin u ftua të merrete pjesë Mitropolia e Shenjtë e Janinës së bashku me Universitetin e Janinës, si koordinator kryesor i projektit, Mitropolitë e Shenjta të Korçës dhe të Gjirokastrës dhe Bashkia e Gjirokastrës nga Shqipëria. Me anë të kësaj veprimtarie, që kërkonte njohuri, aftësi, punë të palodhur organizative e koordinuese, disiplinë menaxheriale dhe përdorim të teknologjive e mjeteve të reja, arrihet të kuptohet se sa i rëndësishëm është kontributi i të tjerëve, ekspertëve të çdo fushe, të arsimit dhe të trajnuar, për të pasur një rezultat të mirë dhe të dobishëm në praktikë, i cili do të shfaqë, në formë të ndryshme, rrezatimin e vlerave të monumenteve që zbukurojnë zonën e gjerë të Janinës dhe të Epirit, por edhe përtej kufirit, Shqipërinë fqinje.

Kontributi i Universitetit të Janinës, nën kujdesin veçanërisht të ndjeshëm të ish-Rektorit, Profesor z. Georgios Kapsalis dhe bashkëpunëtorëve të tij, është vendimtar si në fushën e koordinimit, të shërbimit të informacionit të saktë dhe të drejtimit të pjesëmarrësve të tjerë në projekt, ashtu edhe në hartimin dhe paraqitjen përfundimtare të punës, që është detyrim i palëve. Së bashku me bashkëpunëtorët kompetentë nga Prefektura e Epirit, Bashkia e Gjirokastrës, Mitropolitë e Shenjta të Korçës dhe të Gjirokastrës, u përpoqëm të prezantojmë në tërësi shtigjet e vendeve të lutjes dhe objekteve të kultit në zonat e lartpërmendura, por që njëkohësisht tregojnë edhe rrjedhën historike, veprimtarinë, jetën, gjurmët kulturore e shpirtërore të kaq shumë njerëzve dhe kaq shumë brezave që jetuan, u endën, e deshën, u larguan dhe ndoshta e rizbuluan këtë vend, punuan, krijuan, ofruan dhe i shërbyen.

Në të vërtetë, përmes studimit të historianëve dhe arkeologëve, kontributit të teologëve, klerikëve dhe laikëve, syrit me përvojë të fotografëve, dijeve të atyre që përvijuan shtigjet, përdorimit të teknologjive të reja nga teknokratët, krijimit të materialit audiovizual me bashkëpunimin e të gjithëve, përtej fuqisë dhe efektivitetit të sinergjisë, mësojmë dhe vetë gjëra të reja, por na jepet edhe mundësia t'i ndajmë ato me një numër të pakufizuar përdoruesish të mjeteve dhe pajisjeve që krijuam. Gjithashtu, një mundësi tjetër është përdorimi i këtyre mjeteve për organizimin dhe paraqitjen e informacioneve, monumenteve dhe të dhënave të tjera që kanë të bëjnë me zonat referuese të projektit.

Nëpërmjet këtij procesi bëhemi, në një farë mënyre, pjesëmarrës në punën e atyre njerëzve që i krijuan këto pelegrinazhe, të dashurisë së atyre që ofruan gjithçka për funksionimin, mirëmbajtjen, dekorimin dhe zbukurimin e tyre.

Bëhemi aksionarë të ideve arkitekture, teknikave të ndërtimit të kishave, arteve të mrekullueshme të shenjta dhe të krijuesve që na i ofruan në kohën e tyre për t'i shijuar diakronikisht. Të gjithë këta elementë bëhen pjesë e adhurimit dhe lavdërimit të Zotit, pasi fshehtas dhe haptas shpalosin së bashku marrëdhënien përjetuese me Hyjnoren, besimin, por edhe marrëdhënien me jetën, personat, sendet dhe mjedisin, ashtu siç besimi e ka formësuar dhe vazhdon ta formësojë në një rrugëtim ndërveprues shekullor.

Ndihemi tejet të kënaqur që projekti është ndërkufitar. Kësisoj, ai ndihmon për të kuptuar marrëdhëniet dinamike ndër shekuj me fqinjët tanë, ngjashmëritë që kemi, trashëgiminë dhe përgjegjësinë e përbashkët për ta ruajtur atë, si edhe marrëdhëniet e respektit reciprok, mbështetjes së ndërsjellë dhe udhëtimit së bashku drejt së ardhmes sonë të përbashkët. Ata që do të vizitojnë burimet e informacionit dhe mjetet elektronike e digjitale, do të kenë mundësinë të njihen me këto të dhëna, por edhe të planifikojnë pelegrinazhe në të dyja anët e kufirit, duke përfutur nga afërsia e zonave tona.

Mitropolia e Shenjtë e Janinës është e lumtur që merr pjesë në këtë projekt së bashku me partnerët e tjerë. Sigurisht, kjo ndjenjë gëzimi shumëfishohet nga mundësia e bashkëpunimit me Mitropolitët fort të respektuar të Korçës dhe të Gjirokastrës, prania dhe dëshmia orthodhokse e të cilëve është mbresëlënëse në çdo fushë të ofrimit dhe veprës së tyre shpirtërore, baritore e kulturore. Njëkohësisht, Mitropolia jonë shfrytëzon një hapësirë të re, në sheshin "Patriarku Vartholome", një sallë të re shumëfunktionale përballë kishës së Shën Paisit, e cila tani e tutje do të funksionojë si vend për t'u informuar dhe prezantuar me këtë projekt përmes mjeteve moderne elektronike, të cilat janë instaluar dhe përditësohen pa ndërprerë me materiale audiovizive. Ky sistem do të përdoret për të paraqitur materiale ekzistuese, si dhe materiale që Mitropolia e Shenjtë e Janinës do të vazhdojë të krijojë në të ardhmen për monumentet dhe objektet e shenjta në zonën e juridiksionit të saj.

Shprehim ngrohtësisht falënderime të merituar dhe bujarisht bekojmë të gjithë bashkëpunëtorët që kontribuan në këtë projekt. Falënderojmë partnerët institucionalë të projektit, siç janë Mitropolitë e Shenjta dhe Mitropolitët e hirshëm të Gjirokastrës dhe të Korçës, Prefekturën e Epirit dhe Prefektin e saj, z. Kahrmanis dhe bashkëpunëtorët e tij, Bashkinë e Gjirokastrës dhe natyrisht Universitetin e Janinës, me ish-Rektorin e saj dhe Profesorin e Pedagogjisë z. Georgios Kapsalis, shpirtin e projektit, së bashku me bashkëpunëtorët e tij të nderuar. Falënderojmë me mirënjohje klerikët tanë, presbiterin Grigorios Manopoulos dhe dhjakun Bissarion Vakaros, arkeologun znj. Eleni Michou, klerikët dhe bashkëpunëtorët tanë laikë, të cilët kontribuan në të gjitha proceset e zbatimit të projektit dhe sigurisht drejtuesit dhe stafin e kompanive, të cilët, si kontraktorë, morën përsipër zbatimin e fazave më vete të projektit në nivele të ndryshme pune, nga kërkimi deri te botimi, përkthimi, reklamimi, menaxhimi, por edhe krijimi i programeve, instalimeve të pajisjeve elektronike etj. Me sigurinë se ky projekt do të ndihmojë realisht në njohjen më të mirë të zonës dhe në forcimin e lidhjeve tona me të gjithë pjesëmarrësit, urojmë rrugëtim të mbarë, të funksionojë si duhet në të dyja vendet, në Greqi dhe Shqipëri, për të forcuar marrëdhëniet tona ndërkombëtare e kishtarë dhe për të nisur bashkëpunime të reja për të mirën e vendit tonë dhe të popullit tonë.

Mitropolit i Janinës
+ Maksimi





Parathënie e Mitropolitit të Gjirokastrës, Hirësi Dhimitrit

Qysh prej eposit Homerik kemi dëshmi të qarta mbi nevojën qenësore të njeriut për të vizituar monumente të natyrave të ndryshme, kryesisht me referencë fetare për qetësim trupor dhe shpirtëror. Por edhe përmes Shkrimit të Shenjtë i shohim Judenjtë por edhe vetë Shpëtimtarin tonë me nxënësit e Tij duke vizituar qendrën religjioze të fesë Judaice, Tempullin e Solomonit, për T'i dhënë Perëndisë nder dhe adhurim.

Ky zakoni i bekuar u ruajt edhe në periudhat në vijim, ku vende të shenjtëruara me gjakun martir të homologjetëve të besimit të Krishterë ose nga mundimet asketike të personave që çelnin rrugët e vrytytit, u shenjtëruan duke zotëruar kështu destinacion të ri dinamik dhe liturgjik, ndërsa në të njëjtën kohë përbëjnë edhe pikë destinacioni për gjithë ata sa dëshirojnë të përfetojnë njëfarë lartësimi shpirtëror.

Monumente të tilla të shumëllojshme nuk lidhen vetëm me nevojën fetarologjike të njeriut. Ekzistojnë edhe komplekse kulturore arkitektonike që reflektojnë përparimin dhe civilizimin e një kombi, një shteti, apo një epoke historike... Këto monumente nuk përbëjnë thjeshtë, stoli kulturore të trevës që i përkasin, por përbëjnë elementë të figurshëm që flasin me zë të fort për qytetërimin e saj. Nuk janë gurë të pashpirtë që i nënshtrohen korozionit të pamëshirshëm të kohës: përbëjnë pika referimi të gjalla, fragmente të një historie të pandërprerë që dëshmojnë dhe arshivojnë rrugëtimin e saj përmes ndikimeve reciproke dhe imponimit të ngjarjeve historike që shënuan vendin dhe territorin konkret. Kontribut të kësaj natyre: fetar, shpirtëror, kulturor, edukues, civilizues dhe social, përcjellin Manastiret dhe Kishat e hirshme të Mitropolisë së Shenjtë të Gjirokastrës. Të shpërndara, në gjithë gjatësitë dhe gjerësitë ku kufizohet Mitropolia jonë, qëndrojnë roje të pagjuma shpirtërore dhe përmes heshtjes së tyre të zëshme dhe njëherësh të shurdhët, shpallin atë pasuri të mitrës së Krishterë brenda së cilës u formësuan dhe u lindën.

Këto ndërtesa të nderuara fetare në rradhë të parë janë Vende të Shenjta... Janë streha të adhurimit dhe lavdërimit të Perëndisë sonë Triadik... Janë vende jetike të paqimit, lartësimit dhe ringritjes shpirtërore të njeriut në gjendjen e tij pas rënies dhe në rrugëtim shpëtimi. Dhe si të tilla duhet t'i shohim dhe t'u qasemi. Është për këtë arsye që një nga përkujdesjet e para të Fortlumluturisë së Tij Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Anastas, ishte restaurimi dhe rehabilitimi liturgjik i tyre. E dinte shumë mirë se edhe përmes kësaj mënyre mund të rindizej flaka e besimit të njerëzve, e cila për shkak të periudhës së gjatë ateiste, kishte nisur të shndërrohej në shkëndijë dhe gradualisht në hi të djegur... Dhe përpjekja e tij, me hirin e Perëndisë, lidhi fryte dhe tanimë shijojmë frutat e lëngshme shpirtërore të saj dhe së bashku me ne edhe të gjithë sa për motive pëlegrinazhi dëshirojnë dhe i vizitojnë.

Mitropolia e Shenjtë e Gjirokastrës, me uratat dhe bekimin e Fortlumenturisë së Tij Kryepiskopit Anastas, me interes të veçantë, respekt dhe dashuri ju përgjegj ftesës së Institucionit Universitar të Janninës, për të realizuar projektin “PROSFORA” për promovimin e monumenteve të trashëgimisë religjioze dhe kulturore që stolisin, por edhe aq shumë i ngarkojnë me përgjegjësi trevat tona dhe secilin prej nesh.

Nga ky pozicion shpreh falenderimet e mia të ngrohta Zotit tonë të Gjithëpushtetshëm për bekimet e pasura që i ka dhuruar Mitropolinë historike të Gjirokastrës, për Fortlumenturinë e Tij Kryepiskopin Anastas, i cili pa u lodhur dhe duke u sakrifikuar mundohet për restaurimin, shpëtimin dhe promovimin e monumenteve fetare dhe përmes tyre të Orthodhoksisë, por edhe për civilizimin, progresin dhe ripagëzimin shpirtëror të njerëzve. Falenderime, gjithashtu, i shkojnë për shtat edhe z. Georgios Kapsalis dhe gjithë bashkëpunëtorëve të tij, të cilët u lodhën për përgatitjen e këtij vëllimi. Puna vetmohuese, njohuritë, interesi i pandërprerë hulumtues dhe më në përgjithësi sakrificat e tyre sollën në përmbylljen e këtij botimi të hijshëm me të cilin gëzohemi sot.

Lavdi Perëndisë gjithmonë dhe për gjithshka!

Me nderime dhe vlerësime

Mitropoliti i Gjirokastrës
+ **Dhimitri**



Parathënie e Mitropolitit të Korçës, Hirësi Joanit

I përhapur në territorin e sotëm të Shqipërisë që në shekullin e parë, Krishterimi ka krijuar një traditë të gjatë e të pasur dhe ka lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin kulturor dhe shpirtëror të popullit tonë. Monumente të ndryshme të arkitekturës kishtarë që datojnë nga periudha paleokristiane deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë, vepra të ikonografisë monumentale, ikona, mozaikë, kodikë të purpurt e të dekoruar me miniatura të mrekullueshme, punime arti në metal, qëndistari, drugdhendje dhe skulpturë, depozitojnë një dëshmi shumë të vyer për gjallërinë, lulëzimin kulturor dhe historinë e bashkësive orthodhokse gjatë këtyre shekujve. Karakteri gjithëpërfshirës i trashëgimisë orthodhokse ka formuar një traditë fetare, një kulturë, një fizionomi lokale me vlera të përveçme, por edhe universale.

Ekzistenca e kaq shumë kishave, manastireve dhe vendeve të shenjta kontribuoi në krijimin dhe zhvillimin e pelegrinazhit, traditë që gjurmohet në vendin tonë që në periudhën paleokristiane, ku një vend të veçantë zinte manastiri i Dyzet Shenjtorëve në Sarandë, i themeluar në gjysmën e dytë të shek. V si qendër e rëndësishme për pelegrinët e shumtë të kohës.

Ndonëse në kohërat e vjetra pelegrinazhi ishte një aventurë jo gjithnjë e sigurt për jetën e udhëtarit, sot ai është kthyer në mjet argëtimi dhe çlodhjeje, në burim njohurish dhe përtëritjeje shpirtërore. Fenomeni i pelegrinazhit ka natyrë të shumanshme; nga njëra anë, gërsheton aspekte teologjike, antropologjike, filozofike dhe psikologjike dhe, nga ana tjetër, ka dimensione ekonomike, shoqërore e politike.


Kisha Orthodhokse fton çdo njeri besimtar të vizitojë vendet e shenjta, ku fuqia dhe dashuria e Perëndisë u zbulua përmes mrekullive. Këto vende të adhurimit, që mbështetën popullin në të gjitha sprovat e tij ndër shekuj, i ofrojnë edhe sot pelegrinit përtëritje shpirtërore përmes lutjes dhe adhurimit. Nga ana tjetër, lidhja me kulturën e vendit dhe artin e kohës i bëjnë këto destinacione veçanërisht tërheqëse për besimtarët, vizitorët akademikë, udhëtarët e historisë dhe të kulturës, artdashësit, dashamirësit e natyrës, njerëzit që kërkojnë përvojën autentike të një mënyre jetese në një komunitet të gjallë.

Mitropolia e Shenjtë e Korçës, e ndërgjegjshme për përgjegjësinë historike që ka në mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve kishtarë dhe vendeve të pelegrinazhit të zonës së saj, u bë pjesë energjike e projektit "Pilgrimage tours & pilgrimages to Greece and Albania" - PROSFORA, duke zhvilluar bashkëpunime cilësore me partnerët pjesëmarrës: Universitetin e Janinës, Prefekturën e Epirit, Mitropolinë e Shenjtë të Janinës, Mitropolinë e Shenjtë të Gjirokastrës dhe Bashkinë e Gjirokastrës. Fryt i këtij bashkëpunimi është dhe ky botim që mbani në duar. Falënderime të përzemërta dhe përgëzime meritojnë të gjitha institucionet partnere për bashkëpunimin e frytshëm që patëm gjatë zbatimit të projektit dhe gjithë sa kontribuan në realizimin e këtij botimi të veçantë.

Zbatimi i projektit me krijimin e shtigjeve alternative të pelegrinazhit në zonën tonë, besojmë se do të ndikojë pozitivisht jo vetëm në mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore, por do të rrisë edhe prosperitetin ekonomik të komuniteteve lokale. Njëherësh, hapësira e gjerë gjeografike e veprimit të projektit mes dy vendeve fqinje, Shqipërisë dhe Greqisë, do të vadisë rrënjët e thella të besimit dhe të adhurimit që ekzistojnë si në Greqi, ashtu edhe në Shqipëri dhe rrjedhimisht edhe perceptimet dhe marrëdhëniet shpirtërore e fetare që u zhvilluan mes dy vendeve tona ndër shekuj e që ruhet deri më sot.

Mitropoliti i Korçës
+ Joani







Monumentet e rajonit të Janinës



Manastiri i Hirshëm "Shën Nikolla" i Filantropinëve në Ishullin e Janinës

Manastiri i hirshëm "Shën Nikolla" i Filantropinëve ose i Spanuve, një monument "stacion" falë afreskut integral imponues, ndodhet në një nivel të ngritur, në qoshen jugperëndimore të zonës së banuar të ishullit të Janinës. Është themeluar nga dega epirote e familjes bizantine kostandinopolitane të Filantropinëve, të cilët u vendosën në Janinë pas pushtimit të Kostandinopojës nga Kryqtarët, në vitin 1204. Në vitin 1291/2, Mihal Filantropini e ringriti nga themelet ose e rinovoi rrënjësisht manastirin, i cili ekzistonte i strukturuar në ishull që në shek. XIII-XIV. Manastiri përjetoi një lulëzim të veçantë në shek. XVI, kur, me nismën e igumenëve Neofit dhe kryesisht Joasaf Filantropinit, katolikoni i tij u rinovua, u zgjerua dhe u pikturua. Në shekujt pasues, manastiri vijoi të kishte një shkëlqim të veçantë shpirtëror në zonë dhe gjatë gjithë veprimtarisë së tij ruajti marrëdhënie të drejtpërdrejta me qytetin e Janinës. Kohë pas kohe manastiri ka pasur një përkrahje të rëndësishme me anë të donacioneve që jepnin mërgimtarët janinjotë, si Zotos dhe Apostolos Cigaras, tregtarë të vendosur në Venecia, apo nga familja Spanu, me të cilët u lidh më vonë. Për këtë arsye shpeshherë manastiri përmendet edhe si manastiri i Shën Nikollës "së Spanuve".





Një pjesë e vogël nga faza bizantine e kompleksit është ende e dukshme sot. Katholikoni, ndërtesa më e vjetër e kompleksit, në fillim ishte një kishë njënefëshe me çati druri dhe absidë gjysmërrethore në lindje. Përbëhej nga naosi me hijeroren dhe narteksin, të cilat qarkoheshin nga tre ekzonarteksë me sipërfaqe jo të barabartë. Forma aktuale e kathedronit është rezultat i ndërhyrjeve të gjera, të ndërmarra nga Joasaf Filantropini në dy faza të njëpasnjëshme, më 1542, me zëvendësimin e çatisë prej druri me një qemer gjysmëcilindrik të zgjatur, dhe më 1560, kur forma e saj fillestare u rrethua nga të tria anët, në veri, jug dhe perëndim, me ekzonarteksë me qemerë.







Interieri i kishës u zbukurua me pikturë të mrekullueshme murale, e përbërë nga qindra paraqitje dhe figura shenjtore, e cila u ekzekutua në tri faza të ndryshme kohore. Piktura e fazës së parë mbulon pjesën e poshtme të mureve të naosit dhe i takon periudhës së viteve 1531/2, përpara ristrukturimit të kishës. Në fazën e dytë, që i takon vitit 1542, u pikturua kupola e re e kishës dhe narteksi (lite) me ndikime nga piktori i shquar nga Thiva, Franko Katelani apo edhe me praninë e tij. Së fundi, gjatë fazës së tretë, në vitin 1560, u pikturuan tre ekzonarteksët e kishës nga vëllezërit piktorë, gjithashtu nga Thiva, Jeorgj dhe Franko Kontari. Këto afreske përbëjnë një nga veprat kulmore të së ashtuquajturës “Shkolla e Greqisë Veriperëndimore”, një pikë referimi për studimin e kësaj lëvizjeje artistike, si edhe një model udhërrëfyes ikonografik për shumë piktorë të mëvonshëm.

Këto afreske përbëjnë një nga veprat kulmore të së ashtuquajturës "Shkolla e Greqisë Veriperëndimore"

Programi ikonografik i kishës përmban, sipas sektorëve të organizuar në cikle, historinë e Krishtit dhe të së Tërëshenjtës Mari, martirizime shenjtorësh, jetën e Shën Nikollës dhe skena të tjera nga kalendari mujor, histori nga Dhiata e Vjetër, shfaqje hyjnore dhe vizione, skena eukaristike dhe simbolike, Gjykimin e Fundit, shenjtorë të Kishës, të vendosur sipas rendit hierarkik, si dhe të urtët helenë.

Piktura murale e manastirit të Filantropinëve, me pasurinë e saj të paarritshme ikonografike dhe origjinalitetin e strukturimit, është, ndoshta, dekorimi më ambicioz i pikturimit të një kisha, që na ka lënë arti i periudhës së lulëzimit të shek. XVI, duke e bërë atë një monument të rrallë dhe të patejkalueshëm për llojin, që ruan njohuritë për kohën.





BIBLIOGRAFIA:

Αχειμάστου-Ποταμιάνου Μ., Η Μονή των Φιλανθρωπινών και η πρώτη φάση της μεταβυζαντινής ζωγραφικής, Αθήνα 1995.

Αχειμάστου-Ποταμιάνου Μ., «Οι τοικογραφίες της Μονής του Αγίου Νικολάου των Φιλανθρωπινών, κορυφαίο μνημείο της Ηπείρου», Μοναστήρια Νήσου Ιωαννίνων Πρακτικά Συμποσίου, ed. Μ. Γαρίδης-Α. Παλιούρας, Ιωάννινα 1999, fq. 17-36.

Καμαρούλιας Δ., Τα μοναστήρια της Ηπείρου, völl. I, Αθήνα 1996.

Καραμπερίδη Α., «Η Μονή του Αγίου Νικολάου των Φιλανθρωπινών», Τα Βυζαντινά μνημεία της Ηπείρου, Υπουργείο Πολιτισμού, 8η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων, Ιωάννινα 2008, fq. 153-160.


Καραμπερίδη Α., «Η Μονή Αγίου Νικολάου των Φιλανθρωπινών ή Σπανού», Μνημεία των Ιωαννίνων, Πόλη, Νησί, Λεκανοπέδιο, ΥΠΠΟ – 8η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων, Ιωάννινα 2012, fq. 130-138.

Παναγιωτουνάκου-Πατσουμά Α., «Τα μοναστήρια του Νησιού της λίμνης των Ιωαννίνων ως αρχιτεκτονικές συνθέσεις», Μοναστήρια Νήσου Ιωαννίνων - Πρακτικά Συμποσίου, ed. Μ. Γαρίδης-Α. Παλιούρας, Ιωάννινα 1999, fq. 269-272.

Τριανταφυλλόπουλος Δ., «Βυζαντινά, μεσαιωνικά και νεότερα μνημεία Ηπείρου», ΑΔ 29 (1973-1974) Β2 Χρονικά, fq. 606-608.

Τριανταφυλλόπουλος Δ., «Μεταβυζαντινή τέχνη (1430-1913)», Ήπειρος, 4000 χρόνια ελληνικής ιστορίας και πολιτισμού, Αθήνα 1997, fq. 318-332.

Χατζηδάκης, Μ., Έλληνες Ζωγράφοι μετά την Άλωση (1450-1830), völl. I, Αθήνα 1987.





Kisha e Hirshme e Metamorfozës së Shpëtimtarit, Klimatia

Kisha e Metamorfozës së Shpëtimtarit ndodhet afër Klimatiasë, në veriperëndim të saj dhe është e rrethuar nga muri i ulët i oborrit. Thjeshtësia e monumentit nga jashtë bie në kontrast me dekorimin e brendshëm, i cili e rendit atë ndër ansamblet më të shquara të pikturës pasbizantine të Epirit. Mbishkrimi ktitorik na informon se kisha është ndërtuar nga themelet dhe është pikturuar në vitin 1568, edhe pse nga të dhënat e regjistrimit të vendbanimit, dihet se ajo ekzistonte tashmë që në vitin 1564. Viti 1568 i referohet pikturimit të saj nga dora e piktorit nga Thiva, Franko Kontari, dhe ndoshta edhe rinovimit të ndërtesës, ndërsa nisma për rindërtimin nga e para u ndërmor nga igumen Mitrofani.





Kisha është njëefëshe me përmasa të vogla, me qemer, absidë trefaqëshe dhe, në perëndim, me narteks të mëvonshëm, pa pikturë murale; data e ndërtimit të narteksit nuk është e njohur. Sot, hyrja në kishë bëhet nga ana perëndimore e narteksit dhe e naosit. Në veriperëndim të kishës ngrihet kambanorja, ndërtim më i ri, ndërsa në jugperëndim ruhen rrënojat e ndërtesave, nën të cilat qëndron një hapësirë e madhe me qemer me përdorim të panjohur, por sipas traditës, funksiononte si Shkollë e Fshtëtë.

Kisha është dekoruar me pikturë murale të ruajtur mirë në hapësirën e naosit dhe të hijerores, ku paraqiten tema nga cikli eukaristik, kristologjik dhe theomitorik. Në hijerore spikasin skenat e Ngjites së Zotit në Qiej dhe ajo e Liturgjisë Hyjnore, ndërsa në naos, në qendër të qemerit, dominon Krishti Pantokrator (i Gjithëpushtetshëm), rreth të cilit është organizuar programi ikonografik. Në murin perëndimor veçon skena me shumë personazhe e Kryqëzimit të Krishtit dhe në murin verior tema jashtëzakonisht e rrallë dhe interesante “Ngrihuni, o dyer”, e njohur nga atelieja e Kontaridhëve. Programi ikonografik dhe interpretimi i temave të kishës zbulojnë afritetin dhe marrëdhëniet shumëplanëshe me ato të kishave të Shën Dhimitrit të Klimatiasë dhe të manastirit të Eleusës në ishullin e Janinës, duke ndjekur në organizim parimet e përgjithshme të rymës artistike të Shkollës së Greqisë Veriperëndimore, me pikë referimi manastirin e Shën Nikollës të Filantropinëve. Gjithashtu, në detaje të veçanta ikonografike vihen re ndikime nga piktura perëndimore, nga piktura bashkëkohore dhe e mëhershme e Italisë, Evropës Qendrore dhe e Rilindjes së hershme.





Piktura murale karakterizohet nga një prirje e theksuar narrative, paraqitja figurative e ngjarjeve, dramatizmi dhe intensiteti në skena dhe shfaqja e figurave njerëzore si rregull me përmasa harmonike.



Ikonostasi i sotëm prej druri dhe ikonat që e zbukurojnë atë janë të një periudhe më të re. Ikonostasi i hershëm nuk është ruajtur, ndërsa kanë shpëtuar nga ai, në gjendje të mirë, tri ikona: ajo e Krishtit Pantokrator, e Virgjërshës Odhigjitrja (Udhërrëfyesja) dhe e Metamorfozës së Shpëtimtarit. Stili i tyre artistik tregon se dy të parat janë pikturuar nga i njëjti piktor, ndërsa ikona e tretë është vepër e një piktori tjetër. Nga ikonostasi i vjetër ruhen, gjithashtu, kanatet e Derës së Bukur me skenën e Ungjillëzimit të Hyjllindëses, brezi i sipërm i Apostujve me ikonën e Deisis (Lutja) në qendër dhe nga të dyja anët ikonat me figura të plotë të Apostujve, vepra të cilat duhet t'i atribuohen të gjitha një atelieje piktorësh lokale të gjysmës së dytë të shek. XVI.



Kisha është dekoruar me pikturë murale të ruajtur mirë në hapësirën e naosit dhe të hijerores, ku paraqiten tema nga cikli eukaristik, kristologjik dhe theomitorik.



BIBLIOGRAFIA:

Αχειμάστου-Ποταμιάνου Μ., Η Μονή των Φιλανθρωπινών και η πρώτη φάση της μεταβυζαντινής ζωγραφικής, Αθήνα 1995.

Ευαγγελίδης Δ., «Ο ζωγράφος Φράγκος Κατελάνος εν Ηπείρω», ΔΧΑΕ 1 (1959), Περίοδος Δ΄. Στη μνήμη του Νίκου Βέν (1883 – 1958), Αθήνα 1960, fq. 40-54.

Καμαρούλιας Δ., Τα μοναστήρια της Ηπείρου, völl. I, Αθήνα 1996.

Μανόπουλος Γρ., «Η Βελτοίστα στα 1564 και οι ναοί της», ΗΧ 39 (2005), Ιωάννινα 2005, fq. 455-468.


Μεταβυζαντινά Μνημεία Κληματίας, Υπουργείο Πολιτισμού και Αθλητισμού-8η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων, «Ο ναός της Μεταμόρφωσης του Σωτήρος», ed. Β. Παπαδοπούλου, Ιωάννινα 2014, fq. 85-127.

Μπέττης Σ., «Ο ζωγράφος Φράγκος εκ τόπου Θήβας. Οι εκκλησίες του χωριού Κληματιά (Βελτοίστα)», ΗΕ 7 (1958), Ιωάννινα 1958, fq. 820-827.

Τριανταφυλλόπουλος Δ., «Μεταβυζαντινή τέχνη (1430-1913)», Ήπειρος, 4000 χρόνια ελληνικής ιστορίας και πολιτισμού, Αθήνα 1997, fq. 318-336.

Χατζηδάκης Μ., «Ο ζωγράφος Φράγγος Κονταρής», ΔΧΑΕ 5 (1969), Περίοδος Δ΄. Στη μνήμη του Δημητρίου Ευαγγελίδη (1888-1959), fq. 299-302.

Χατζηνικολάου, Α., «Βυζαντινά και μεσαιωνικά μνημεία Ηπείρου», ΑΔ 21 (1966), Β2΄ Χρονικά, Αθήνα 1968, fq. 296.







Manastiri i Hirshëm i Hyjlindëses, Çukë, Elliniko



Manastiri i hirshëm i Çukës, kushtuar Lindjes së Hyjlindëses Mari, ngrihet në kodrën me të njëjtin emër, 760 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Elliniko të bashkisë së Xhumerkës Veriore. Emërtimi rrjedh nga maja e kodrës së pyllëzuar, në vllahisht “Çuka Analta”, që do të thotë “majë e lartë”. Kodra është lehtësisht e arritshme nga fshati Elliniko, ndërsa në anën lindore është rrethuar dhe formon shpatin e djathtë të thepisur të grykës së Arahthos. Manastiri, që ndodhet në buzë të rrethit, dominon zonën dhe shihet nga të gjitha anët. Ai ka pamje të mrekullueshme drejt grykës së Arahthos dhe të fshatrave përballë, Peristerit dhe Xhumerkës.





Sipas traditës, një ikonë e Virgjëreshës Mari u gjet në kodrën e Çukës dhe për nder të saj banorët e Elliniko-s ndërtuan një kishëz në kodrën e Shën Marinës, mbi fshat. Ndërkaq, ikona largohej çdo natë për në kodrën e Çukës, duke treguar vendin ku dëshironte të ndërtohej kisha e saj. Përsëri, sipas traditës, manastiri u themelua në vitin 1190 nga perandori Isaku II Angjeli (1185-1195) dhe lulëzoi gjatë kohës së Despotatit të Epirit. U shkatërrua në vitin 1736 dhe u rinovua në vitin 1779 dhe më pas u bë një qendër fetare dhe kombëtare helene, pasi gjatë revolucionit grek të vitit 1821 dhe në të gjitha betejat kombëtare helene, ai ishte kthyer në strehë të revolucionarëve grekë. Manastiri siguroi të ardhura dhe mirëmbante shkollën e fshatit Elliniko. Ai gjithashtu gëzonte famë të madhe, falë burimit të ujit, i cili konsiderohej shërues dhe ishte i kërkuar në të gjithë Epirin. Panairi i manastirit kremtohej më 8 shtator, ishte i famshëm dhe mbledhte shumë njerëz, mes tyre dhe shumë të sëmurë që kërkonin shërim. Pas fillimit të shek. XIX, menaxhimi i keq e çoi manastirin në rënie. Për shumë vjet mbeti i braktisur, derisa u rehabilitua në fund të viteve 1990, kur qelitë dhe objektet ndihmëse të tij u restauruan.





Manastiri ka karakter fortese dhe është i rrethuar me mure të larta. Hyrja e manastirit është zbuluar me gdhendje në gur. Përveç ktholikonit, ai përbëhet nga një numër ndërtesash të tjera, si konakët, cisterna dhe kulla e kambanores. Konakët dykatësh të qelive janë vendosur në anën jugperëndimore dhe veriore të kompleksit dhe pjesa më e madhe e tyre është ndërtuar në shek. XVIII-XIX. Cisterna me mbulesën e saj ndodhet në anën jugperëndimore të ktholikonit dhe kambanorja e ndërtuar me gurë daton në vitin 1866, sipas mbishkrimit të saj. Në anën jugore të manastirit, afër hyrjes lindore, ndodhet kisha e së Tërëshenjtës, e cila ka pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarri.





Manastiri ka karakter fortese dhe është i rrethuar me mure të larta. Hyrja e manastirit është zbukuruar me gdhendje në gur.




Katholikoni, i ndërtuar me gurë të bardhë të latuar, ndodhet në qendër të kompleksit dhe me gjasë daton në fund të shek. XVII. Kisha është njënefëshe, e tipit kryq i brendashkruar, me portik me dy kolona në hyrjen e saj. Interieri i kishës është dekoruar me pikturë murale. Mbishkrimi mbi hyrjen perëndimore, i cili sot nuk dallohet, na njofton se piktura murale e kishës është realizuar me shpenzimet e ktitorit Aleksios Papajoanu dhe se ikonostasi i gdhendur në dru i kishës, i shquar për dekorimin e imët të luleve, është praruar më 3 tetor 1779 nga piktori kapesovit Athanasi, i biri i piktorit të njohur kapesovit Joani, me shpenzimet e manastirit, në kohën kur ishte igumen Gabrieli.



Sot kompleksi funksionon si manastir burrash. Çdo të kremte, më 8 shtator, organizohet një panair i ndritur, në të cilin mbledhet një numër i madh pelegrinësh.

BIBLIOGRAFIA:

Καμαρούλιας Δ., Τα μοναστήρια της Ηπείρου, νῆλ. Ι, Αθήνα 1996.





Kisha e Hirshme "Shën Gjergji" e Negadhëve



Kisha e hirshme e Shën Gjergjit ngrihet në sheshin qendror të Negadhëve dhe është një nga ansamblët e fundit dhe më të rëndësishme me mure guri në Epir, në shek. XVIII. Negadhes, një fshat në Zagorinë qendrore, lulëzoi gjatë shek. XVIII, falë pasurisë së krijuar nga mërgimi i shumë banorëve në Ballkan dhe marrjes së tyre me tregti.

Kisha është një bazilikë e madhe trinefëshe, me çati druri, me narteks dhe galeri të brendshme mbi narteks që përdorej si gjinekoni dhe me hajat rrethues me kolona, fillimisht në anët veriore dhe jugore, ndërsa në mes të shek. XX u shtua edhe në pjesën perëndimore. Kisha i kushtohet tre shenjtorëve, ku në nefin verior dhe jugor nderohet Trinia e Shenjtë dhe Shën Dhimitrit respektivisht. Ajo zëvendësoi kishën e vjetër me të njëjtin emër të enorisë, ndërtim ndoshta i fillimit të shek. XVIII. Pranë kishës, në anën verilindore, gjendet kambanorja hijerëndë gjashtëkëndore, me hapje të harkuara në pjesën e sipërme të saj. Ndërtimi i kishës filloi më 2 maj 1792, ndërsa piktura murale përfundoi më 10 tetor 1795. Ktitori dhe donatori i kishës është tregtari Matthe Gjini.



Piktura murale është vepër e piktorëve kapesovitë, Joan Anagnosti dhe i biri, Anastasi, të cilët rrjedhin nga familje me tradita në pikturë. Joani është piktori më i rëndësishëm kapesovit dhe në këtë monument është ngulitur kulmi i pjekurisë së tij artistike. Nga ana tjetër, Anastasi, tashmë prej nëntë vitesh në atelienë e të atit, është bërë një piktor i aftë. Në kishën e madhe të Shën Gjergjit, piktorëve iu dha mundësia të zhvillonin një program shumë të pasur ikonografik.



Vlen të përmenden
skenat e njëzet e katër
Stancave të Himnit
Akathist, të realizuara
në po aq hapësira,
cikli i shtatë Sinodeve
Ekumenike, por edhe
dy të urtët e antikitetit,
Plutarku dhe Aristoteli



Kisha është e mbushur me skena të vendosura në zona, të cilat kufizohen nga shirita të kuq. Piktura murale përmban skena nga cikli kristologjik (skena nga jeta e Krishtit) dhe theomitorik (skena nga jeta e Virgjëreshës Mari), skena eukaristike dhe tema me karakter liturgjik. Në pjesën e poshtme të mureve paraqiten shenjtorë me pamje të plotë. Vlen të përmenden skenat e njëzet e katër Stancave të Himnit Akathist, të realizuara në po aq hapësira, cikli i shtatë Sinodeve Ekumenike, por edhe dy të urtët e antikitetit, Plutarku dhe Aristoteli, të paraqitur me veshjen e dijetarëve perëndimorë. Ngjyrat mbizotëruese janë e kuja, e alternuar me jeshilen e errët, të verdhën, blunë dhe grinë në të bardhë. Përdorimi i ngjyrave në disa raste thekson simetrinë e kompozicionit.





Dy piktorët, Joani dhe Anastasi, janë jashtëzakonisht eklektikë në përzgjedhjet ikonografike. Modellet e tyre merren kryesisht në veprat e piktorëve Linotopitë të shek. XVII dhe nga tematika e pasur e monumenteve të mëdha të shek. XVI të Greqisë Veriperëndimore, të tilla si manastiri i Filantropinëve dhe kisha e Metamorfozës së Klimatiasë. Njëkohësisht, ata asimilojnë elemente organike të artit perëndimor, të pasuruar me elemente laike, zakonisht në detaje ikonografike, në përputhje me prirjet e Barokut Perëndimor, një estetikë e re, mbartës të së cilës bëhen tregtarët që e sjellin në qendrat ekonomike të shoqërisë osmane dhe evropiane të shek. XVIII. Të dy piktorët mbështeten në vlerat të qëndrueshme të traditës, por në të njëjtën kohë, perceptojnë pulsën e kohës së tyre. Përzgjedhja selektive e modeleve të tyre pasqyron kërkimet shpirtërore, teologjike dhe shoqërore të kohës dhe marrëdhëniet e ktitorëve me kulturën e Evropës Perëndimore.



BIBLIOGRAFIA:


Κοντοπανάγου Α., Ο Ναός του Αγίου Γεωργίου Νεγάδων στην Ήπειρο (1795) και το έργο των Καπεσοβιτών ζωγράφων Ιωάννου και Αναστασίου Αναγνώστη, Διδακτορική διατριβή, Ιωάννινα 2010.

Κωνσταντίνος Δ., Προσέγγιση στο έργο των ζωγράφων από το Καπέσοβο της Ηπείρου. Συμβολή στη μελέτη της θρησκευτικής ζωγραφικής στην Ήπειρο τον 18ο αι. και το α΄ μισό του 19ου αι., νέκλ. Ι, Teksti, Αθήνα 1997.

Μανόπουλος Γρ., «Επανεξέταση των επιγραφών των καπεσοβιτών ζωγράφων», ΗΧ 37 (2003), Ιωάννινα 2003, fq. 299-316.

Παπαγεωργίου Γ., Οικονομικοί και Κοινωνικοί Μηχανισμοί στον ορεινό χώρο. Ζαγόρι (μέσα 18ου αι.-αρχές 20ου αι.), Ιωάννινα 1995.

Χατζηδάκης Μ., Έλληνες Ζωγράφοι μετά την Άλωση (1450-1830), νέκλ. Ι, Κέντρο Νεοελληνικών Ερευνών, Ε.Ι.Ε., Αθήνα 1987





Kisha e Hirsheme e Shën Nikollës, Agora, Janinë



Kisha “Shën Nikolla” e Agorasë ndodhet në Janinë, në rrugën e sotme “Haxhikonsta”, në qendrën historike të qytetit. Kisha ka ekzistuar që në fillim të shek. XVII, sipas një dokumenti të korrikut 1628, si dhe të një shënimi përkujtimor në librin e muhorit të korrikut të kishës së Shën Nikollës, Kopanon, ku përmendet se më 19 shkurt 1630 djali i Rexhep agës shkatërroi kishën e Shën Nikollës së Agorasë. Deri më 2 dhjetor 1647, kisha nuk ishte rindërtuar. Ajo përmendet përsëri në mars 1749, por përsëri nuk bëhet e ditur viti i saktë i ringritjes së saj. I vetmi fakt i sigurt është se kisha u rindërtua midis viteve 1647-1749. Ajo u shkatërrua sërish gjatë përlëshjeve të përgjakshme midis Ali Pashës dhe Hurshit Pashës, dhe shkatërrimit të Janinës në vitin 1822 nga trupat e sulltanit. Rindërtimi i dytë, që i dha kishës pamjen e sotme, filloi në vitin 1837, me donacionet e vëllezërve Zosima dhe të G. Haxhokonstas, i cili ndërtoi edhe spitalin atje pranë dhe përmbylli punimet e kishës në vitin 1842. Ndërkaq, të pakta janë informacionet për historinë e kishës pas përfundimit të punimeve për rindërtimin e saj.





“Shën Nikolla” e Agorasë është një kishë e madhe e tipit bazilikal me tri nefe, me çati druri dhe me absidë shtatëfaqëshe në anën lindore. Çatia e ngritur mbështetet në dy kolonadat e brendshme, me nga pesë kolona guri secila, që ndajnë nefet. Në anën veriore dhe perëndimore, kisha është e rrethuar nga hajati në formë “U”-je, që qëndron i mbështetur në kolona katërkëndëshe. Në të gjithë shtrirjen e tij, hajati përbëhet nga dy kate, me katin e dytë të hapur nga ana e brendshme e kishës, i cili funksionon edhe si galeri e brendshme. Lidhja e kishës me galerinë realizohet përmes shkallëve të jashtme, të ndërtuara në anën veriore dhe jugore. Në fund të galerisë veriore, është trajtuar një kishëz kushtuar Shën Elefërit. Mbi hyrjen e oborrit të kishës në anën jugore, lartësohet kambanorja dykatëshe.





Në frontonët anësorë janë pikturuar skena të veçuara, të cilat nuk janë pjesë e një grupi të vetëm ikonografik, por janë paraqitje të mëvetësishme temash fetare, sipas dëshirave të donatorëve të veçantë.



Kisha mban në interiorin e saj shtrirje të kufizuar të pikturës murale, sikundër ngjet edhe në kishat e tjera bashkëkohëse të qytetit. Për dekorimin e kishës janë përzgjedhur pjesët më të rëndësishme për nga pikëpamja e mesazhit teologjik, siç janë konkat e hijerores dhe kupola qendrore në mes të tavanit. Në vend të kupolës paraqitet Krishti Pantokrator (i Gjithëpushtetshëm), i rrethuar me nga engjëj dhe profetë. Në hapësirat e mureve midis dritareve shfaqen të pikturuar shenjtorë me pamje të plotë. Në frontonët anësorë janë pikturuar skena të veçuara, të cilat nuk janë pjesë e një grupi të vetëm ikonografik, por janë paraqitje të mëvetësishme temash fetare, sipas dëshirave të donatorëve të veçantë. I gjithë trajtimi ikonografik i kishës pasqyron ndikimin e ngadaltë, por gradual të artit perëndimor, me elementë të fortë barokë, por edhe të pikturës Nazarenë, në formimin e pikturës fetare në një qendër urbane, siç ishte Janina, gjatë kësaj periudhe.



Në kishë ruhen ikona dhe objekte me origjinë ruse, shumë prej të cilave janë dhuruar nga Haxhikonsta në vitin 1841, të tilla si ikonat despotike, të ndikuara fuqishëm nga stili i piktorëve Nazarenë.

Sjellja në kishë e ikonave të atelieve ruse të kohës është e lidhur ngushtë me personalitetin e donatorëve, të cilët ishin anëtarë aktivë të komunitetit greko-rus të shek. XIX.



BIBLIOGRAFIA:

Γονατίδης Ι., «Τα ληξιαρχικά βιβλία ναού Αγίου Νικολάου Αγοράς Ιωαννίνων», ΗΧ 38 (2004), Ιωάννινα 2004, fq. 369-397.


Δημητρακοπούλου Π., «Ο ναός του Αγίου Νικολάου Αγοράς», Μνημεία των Ιωαννίνων, Πόλη, Νησί, Λεκανοπέδιο, ed. Β. Παπαδοπούλου, ΥΠΠΟ-8η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων, Ιωάννινα 2009, fq. 94-96.

Κεφαλλώνιτου Φ.-Κωνστάντιος Δ., «Η εισαγωγή κοσμικών στοιχείων στους ναούς των Ιωαννίνων τον 19ο αι.», Ήπειρος 15ος-20ος αι., Πρακτικά Διεθνούς Συνεδρίου Ιστορίας Ήπειρος: Κοινωνία-Οικονομία 15ος-20ος αι., Ιωάννινα 1985, fq. 299-317.

Κωνστάντιος Δ., «Χορηγία και τέχνη στην Ήπειρο την περίοδο της ύστερης Τουρκοκρατίας», ΔΧΑΕ 20 (1998), Περίοδος Δ΄. Στη μνήμη του Δημητρίου Ι. Πάλλα (1907-1995), Αθήνα 1999, fq. 409-416.

Μαυρίκα Β., «Επιρροές της ακαδημαϊκής ζωγραφικής σε τοιχογραφίες ναών στην πόλη των Ιωαννίνων (ύστερος 19ος-μέσα 20ου αιώνα)», Πρακτικά Γ΄ Επιστημονικού Συμποσίου της Νεοελληνικής Τέχνης, Αθήνα 2015, fq. 187-205.

Τριανταφυλλόπουλος Δ., «Μεταβυζαντινή τέχνη (1430-1913)», Ήπειρος, 4000 χρόνια ελληνικής




The background of the entire image is a teal-colored mosaic made of small, irregular square tiles. The tiles are arranged in a pattern that creates a subtle, concentric circular effect, with the center of the pattern located towards the top left of the frame. The text is overlaid on the right side of this mosaic.

Monumentet e rajonit të Gjirokastrës



Kisha Mitropolitane e Metamorfozës së Shpëtimtarit Krisht, Gjirokastër



Kisha e Metamorfozës së Shpëtimtarit ndodhet në qendër të lagjes historike “Pazari i Vjetër”, në Gjirokastër. Kisha ka qenë pjesë e një sistemi arkitektonik më kompleks, i zhvilluar si vazhdim i pjesës lindore të Kalasë. Bëhet fjalë për një fortesë të ngritur mbi kodrën që dominon fushën e Drinos në perëndim, pjesët arkitektonike të së cilës datojnë para shek. XII. Në kishën e Metamorfozës të çojnë rrugët e ngushta me kalldrëm, njëra prej të cilave zbret pothuajse vertikalisht nga kalaja, ndërsa tjetra fillon nga sheshi kryesor.



Rrënojat e ndërtesave të kishës, që janë të dukshme edhe sot, janë tregues për strukturën dhe funksionet fillestare që kishte kompleksi. Ato dëshmojnë për zhvillimin e një veprimtarie të shumanshme, e cila ka të ngjarë të përfshinte shërbime më të gjera administrative, arsimore etj., jo vetëm për nevojat e selisë së Mitropolisë, por edhe të të gjithë komunitetit lokal. Kështu, mbetet e një rezervuari të madh uji të ndërtuar me gurë, madhësia e të cilit është mbresëlënëse, është një nga elementet që pohojnë sa më sipër. Për më tepër, në burimet e shkruara, kishtarë dhe laikë, ruhen informacione të shumta që flasin për rëndësinë dhe jetën intensive shpirtërore, arsimore dhe shoqërore. Të tillë janë kodikët e shpëtuar të Mitropolisë së Drinopojës dhe Gjirokastrës si dhe shënimet e udhëtarëve të shquar, si ai i gazetarit francez Rene Puaux, i cili kishte qëndruar në kishë gjatë Luftërave Ballkanike.

Për dokumentimin e mëtejshëm të kishës, por edhe për studimet e përgjithshme historike, një rëndësi të veçantë kanë mbishkrimet që gjenden si brenda kishës, ashtu edhe në pllakat e murosura jashtë saj. Në faqen e murit perëndimor të kishës ndodhet një mbishkrim, sipas të cilit kisha është ndërtuar në vitin 1776, me iniciativën e episkopit të atëhershëm të Drinopojës dhe Gjirokastrës, z. Dosithe; në të njëjtën kohë, në këtë qytet ekzistonte dhe kisha e Taksiačkëve.



Ato dëshmojnë për zhvillimin e një veprimtarie të shumanshme, e cila ka të ngjarë të përfshinte shërbime më të gjera administrative, arsimore etj., jo vetëm për nevojat e selisë së Mitropolisë, por edhe të të gjithë komunitetit lokal.








Megjithatë, ekzistenca e një tempulli adhurimi në këtë vend, nuk nis në shek. XVIII. Gjatë punimeve për rregullimin e oborrit, u identifikuan varre, të cilat, në ndërthurje me burimet e shkruara historike, dëshmojnë për praninë e një kishëze më të hershme në zonë, e cila gjithashtu i kushtohej Shpëtimtarit Krisht. Gjithashtu, në këtë vend ka ekzistuar edhe një kambanore, e cila u shemb në fund të viteve 60-të dhe në fillim të viteve 70-të, si pasojë e rrethanave të veçanta politike që mbizotëronin atë kohë në Shqipëri. Pas ndryshimeve politike të viteve 90-të, me nisma private, u synua restaurimi i kambanores, sipas fotografive të ruajtura. Por kjo përpjekje nuk rezultoi e suksesshme qoftë për nga materialet e përdorura, qoftë për sa i përket teknikës së zbatuar.

Në gjendjen e sotme, kisha është një bazilikë masive guri, me tri nefe. Në muraturën e jashtme dallohen qartë fazat e ndryshme të ndërtimit, të cilat përfshijnë fazën fillestare, si dhe shtesat pasuese dhe ndërhyrjet e restaurimit, të dukshme kryesisht nga ana jugore e kishës. Gjithashtu, interesante janë elementet arkitektonike në portën perëndimore, që dëshmojnë për komunikimin e kishës me shtëpitë e lagjes përmes një shkalle që të nixirte jashtë nga gjinekoniti.





Në pjesën e brendshme, kisha është e ndarë në nefe, përmes një kolonade të dyfishtë në të dyja anët gjatësore të nefit qendror, me çifte kolonash përkatësisht në skajet perëndimore dhe lindore. Kolonat përfundojnë me harqe të larta dhe madhështore, duke e sjellë kështu boshtin horizontal të kishës në harmoni me atë vertikal. Në absidat e Hijerores vërehet shtimi i elementeve dekorative prej guri, të tilla si shirita, korniza, harqe të gdhendura, por edhe dekore të kufizuara në relief. Relieve të ngjashme në gur janë realizuar në murin jugor, pranë hyrjes kryesore të kishës.

Hijerorja është pjesërisht e pikturuar me afreske të cilat, si në absidën qendrore, ashtu edhe në dy absidat anësore, paraqesin dëmtime të pjesshme. Një interes të veçantë paraqet sinteza e programit ikonografik, pasi në të përfshihen shenjtore që nuk ndeshen shpesh në kishat e zonës. Sipas mbishkrimeve të ruajtura, piktura murale e kësaj pjese u realizua rreth vitit 1860, gjatë kohës kur ishte Mitropolit zoti Pandelejmon. Emri i piktorit nuk përmendet në mbishkrim.

Ndër objektet me vlerë, që ruhen në interiorin e kishës, janë ikonostasi dhe froni i dhespotit. Ikonostasi është i gdhendur në dru dhe përmban elemente dekorative të ndërlikuara në relief, me tema dhe motive interesante. Në gjendje shumë të mirë ruhet edhe froni i dhespotit, i realizuar me teknikë dhe sintezë të ngjashme dekorative.

Për shkak të problemeve të shumta, me nismën dhe kujdesin e Mitropolitit të Gjirokastrës, Hirësi Dhimitrit, në vitin 2011 u realizua konsolidimi dhe restaurimi i pikturës murale. Gjatë ndërhyrjeve të viteve të fundit, u zëvendësua dyshmeja e gjinekinitit të kishës dhe shkalla e hyrjes në të.

BIBLIOGRAFIA:

Popa Th., Mbishkrime të kishave të Shqipërisë. Tiranë: Akademia e Shkencave-Instituti i Historisë, 1998.


Puaux, R. La malheureuse Épire. Paris: Perrin et cie, 1914.

Rembeci, Andi. (editor-in-chief), Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2015. Vol 2: Holy Metropolis of Gjirokastra, Tirana: Ngjallja Publishers, 2015. (Published also in Albanian and Greek).

Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2005 (botuar, gjithashtu, në anglisht dhe greqisht).

Thomo P., Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1998: 152-154.

Πουλίτσας, Παναγιώτης Ἡλ., «Σύνοψις τοῦ κώδικος τῆς ἐπισκοπῆς Δρυϊνουπόλεως καὶ Ἀργυροκάστρου », Ἡπειρωτικά Χρονικά 5 (1930): 76-113.





Kisha e Taksiarkëve të Mëdhenj, Bodrishtë

Bodrishta është një nga fshatrat më të mëdha të Luginës së Dropullit, me prani të lartë të minoritetit etnik grek. Fshati shtrihet pranë qendrës historike të Mitropolisë së Drinopojës. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë për ekzistencën e një vendbanimi të organizuar që nga periudha helenistike. Gjatë periudhës së vonë bizantine dhe në kohët e mëvonshme, komunitetet e vogla të zonës u lidhën me qendra të mëdha urbane në lindje dhe në perëndim, gjë që solli zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të shoqërive rajonale të Perandorisë Osmane. Në të gjithë zonën përreth u ndërtuan shumë kisha dhe manastire pasbizantine, të pranishme edhe sot, duke dëshmuar zhvillimin e asaj periudhe.





Kisha e Taksiarkëve të Mëdhenj ndodhet në qendër të fshatit Bodrishtë, brenda një zone të rrethuar plot gjelbërim. Në qoshen veriperëndimore, si vazhdim i ndërtesës gjendet hajati i mbuluar, me harkadë të hapur në anën perëndimore. Nëse dikush vëzhgon me kujdes oborrin, do të kuptojë se, përveç ndërtesave që janë të dukshme sot, atje kanë ekzistuar më parë edhe ndërtesa të tjera. E tillë ishte kishëza kushtuar Shën Athanasit, e cila, për fat të keq, është shkatërruar plotësisht. Disa varre familjare, që ngrihen hijerëndë në anën jugperëndimore të kompleksit brenda rrethimit, dëshmojnë për funksionin e mëparshëm të vendit.

Sipas traditës, ajo është ndërtuar dhe pikturuar me shpenzimet dhe kujdesin e komunitetit lokal.





Kisha e Taksiarkëve të Mëdhenj u ndërtua gjatë viteve 1778-1780 dhe bën pjesë në listën e kishave që ndërtoi apo meremetoi episkopi Dosithe. Sipas traditës, ajo është ndërtuar dhe pikturuar me shpenzimet dhe kujdesin e komunitetit lokal. Kisha i përket tipit bazilikal trenefësh, me çati dyjësë të mbuluar me rrasa guri, karakteristike për llojin specifik arkitektonik. Në anën perëndimore, ku ndodhet hyrja fillestare e kishës, lartësohet një kambanore në tri nivele, me dritare të harkuara me një dhe dy lobe, shembull tipik i arkitekturës epirote të kambanoreve në trajtë kulle. Së fundi, jashtë murit rrethues të oborrit, në anën perëndimore, në distancë të shkurtër nga kisha, ekziston një faltore e vogël që përkujton vizitën e Shën Kozmait të Etolisë në fshatin Bodrishtë, në një nga udhëtimet e tij, me shumë gjasa në vitin 1777.

Në interiorin e saj kisha zhvillohet e ndarë në tri nefe, të cilat formohen nga kolona të dyfishta, të lidhura me një sistem harqesh në të dyja anët e nefit qendror. Qemerët e vegjël dhe trekëndësja sferikë krijojnë në çati, kryesisht mbi nefin qendror, një sistem interesant e të ndërlkuar mbulesë. Narteksi zhvillohet në anën perëndimore si një ndërtim i mëvonshëm, i cili, me sa duket, funksiononte si gjinekonit me dritare të mbyllura me kafaze të rrjetëzuara, me pamje nga nefet anësore. Në anën veriore gjendet portiku i hyrjes në kishë.

Braktisja për shumë kohë dhe lëvizjet e tokës i kanë shkaktuar kishës dëmtime të konsiderueshme në themele, muraturë dhe pikturën murale. Për shkak të gjendjes së rënduar, mbishkrimet në interiorin e kishës, fatkeqësisht, nuk ofrojnë të dhëna lidhur me ndërtuesit ktitorë, dhuruesit apo piktorët e saj. Fatmirësisht, ka shpëtuar pjesa më e madhe e programit origjinal të pikturës murale, e shtrirë në sipërfaqet e brendshme të mureve të naosit. Në zonën e sipërme, gjenden të pikturuara skena dhe personazhe nga Dhiata e Re dhe e Vjetër, ndërsa në zonat më të ulëta radhiten shenjtorët, të paraqitur bust brenda medaljoneve dhe në nivelet më të ulëta shenjtorët paraqiten me shtat të plotë. Në muret e Hijerores, në anën lindore, ndeshen ndoshta shembujt më mirë të ruajtur të dekorimit ikonografik. Në absidën e Blatës (Prothesis), në të majtë të Hijerores, gjenden mbishkrime murale, në formën e një diptiku, me emrat e banorëve të gjallë dhe të fjetur të Bodrishtës, që nga koha e ndërtimit të kishës si qendër e famullisë.



Për shkak të vjedhjeve të përsëritura, kisha u zhvesh nga një pjesë e ikonave të vjera të lëvizshme dhe dekorimi i gdhendur në dru, vetëm ikonostasi mundi të mbijetojë pjesërisht deri sot. Pjesët e vjedhura nga ikonostasi i vjetër u plotësuan për të kompensuar elementet që mungonin.

Që nga koha e ndërtimit të saj e deri në vitin 1967 kisha ka funksionuar normalisht, duke shërbyer edhe si kishë e varrezave pranë saj. Gjatë regjimit ateist kisha u shndërrua në depo për rreth 20 vjet. Këtë e dëshmojnë edhe shënimet e priftit të kohës në faqet e Ungjillit të kishës. Pas përmbyesjes së regjimit ateist, gjatë viteve 2000-2010, nën kujdesin e Kryepiskopit Anastas, u realizuan punime të plota restauruese të kishës.



BIBLIOGRAFIA:

Popa Th., Mbishkrime të kishave të Shqipërisë. Tiranë: Akademia e Shkencave-Instituti i Historisë, 1998.

Puaux, R. La malheureuse Épire. Paris: Perrin et cie, 1914.


Rembeci, Andi. (editor-in-chief), Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2015. Vol 2: Holy Metropolis of Gjirokastra, Tirana: Ngjallja Publishers, 2015. (Published also in Albanian and Greek).

Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2005 (botuar, gjithashtu, në anglisht dhe greqisht).

Thomo P., Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1998: 152-154.

Πουλίτσας, Παναγιώτης Ήλ., «Σύνοψις τοῦ κώδικος τῆς ἐπισκοπῆς Δρυϊνουπόλεως καὶ Ἀργυροκάστρου», Ἡπειρωτικά Χρονικά 5 (1930): 76-113.

Τα Πανάρχεια Ἑλληνικά Χωριά του Νομοῦ Ἀργυροκάστρου. Ἰωάννινα: Σύνδεσμος συνταξιούχων ἐλληνοδασκάλων ἐλληνικῆς ἐθνικῆς μειονότητας νομοῦ Ἀργυροκάστρου, 2009.





Kisha e Shën Athanasit, Bularat

Fshati Bularat shtrihet rrëzë Malit të Gjerë, në pjesën lindore të tij, dhe është një nga fshatrat më piktoreske të luginës së lumit Drino. Gjetjet arkeologjike të shek. III para Krishtit, si gurë peshe prej balte dhe vula, dëshmojnë për ekzistencën e një vendbanimi si dhe funksionimin e mundshëm të punishteve të qeramikës në zonë. Duke ndjekur një kurs paralel me komunitetet e tjera të rrethit të Gjirokastrës, në periudhën e vonë bizantine dhe në kohët e mëvonshme, banorët e Bularatit zhvilluan një aktivitet intensiv ekonomik, kryesisht në fushën e tregtisë. Si rezultat, në të gjithë zonën u ngrit një numër i konsiderueshëm shkollash dhe kishash.



Kisha e Shën Athanasit ngrihet në hyrjen verilindore të fshatit dhe është pjesë e një kompleksi varrezash, që daton në shek. XVI. Zona rrethohet nga një mur i ulët guri, brenda të cilit ka ekzistuar një kishë e vjetër e periudhës bizantine. Ndoshta, kisha e sotme është ndërtuar mbi themelet e kësaj kisha të vjetër. Terreni rreth kishës zhvillohet me nivele të ndryshme, të cilat lidhen me rrugë me kalldrëm. Përveç varreve të shpërndara, kompleksi përmban një hajat të mbuluar dhe një kambanore tradicionale prej guri, që lartësohet në anën e djathtë të hyrjes kryesore të oborrit të kishës. Kambanorja zhvillohet me tri nivele, me dritare të harkuara me një dhe dy lobe që alternohen respektivisht në nivelin e dytë dhe të tretë.



Ndërtesa e hajatit të mbuluar u shërben më së miri besimtarëve. Bëhet fjalë për një ndërtesë të thjeshtë, të hapur në pjesën më të madhe të anës lindore, me gjashtë harkada të mbështetura në kolona. Çatia ndjek tipin e çatisë së kishës kryesore dhe është e mbuluar me rrasa guri, karakteristikë tradicionale e zonës. Në ditët me shi, besimtarët e përdornin dhe vijnë ta përdorin këtë hapësirë për nevoja të ndryshme kishtare, si për kryerjen e ceremonive funerale apo të lutjeve përkujtimore. Për shkak të braktisjes për një kohë të gjatë, hajati ka nevojë për mirëmbajtje dhe restaurim.

Ndërtesa më e rëndësishme e kompleksit është ajo e kishës, e cila i kushtohet kujtimit të Shën Athanasit, Patriarkut të Aleksandrisë. Kisha ndodhet karshi hyrjes, në anën veriore të zonës së rrethuar të varrezave. Për fat të keq, data e saktë e fazës së parë të ndërtimit të kishës nuk është ruajtur. Sidoqoftë, nga forma e ndërtesës dhe, kryesisht nga interieri, duket qartë se kisha ka kaluar nëpër faza të ndryshme rindërtimi dhe shtesash. Konkretisht, në anën lindore duket qartë bashkëjetesa e elementeve arkitektonike të periudhave të ndryshme, ku pjesa trekonkëshe e Hijerores i përket fazës më të hershme ndërtimore, e punuar në gur me një stil ndryshe nga pjesa tjetër. Në burimet e shkruara dhe mbishkrimet e kishës hasen data të ndryshme të ndërhyrjeve dhe rikonstruktiveve. Referimi më specifik kronologjik i takon një triptiku prej druri, ku përmendet viti 1574.





Kisha është e tipit bazilikë me tri nefë, me çati dyujëse dhe me kupolë me lartësi të ulët, e cila është shtuar më vonë, ndoshta në shek. XIX. Nefet ndahen me dy palë kolona të lidhura me harqe. Hyrja e mbuluar e kishës në anën jugore është gjithashtu interesante. Në mbulesën e nefit qendror zhvillohet një sistem kupolash, qemerësh gjysmësferikë dhe trekëndëshash sferikë, të cilët janë dekoruar me afreske që i përkasin dy fazave të ndryshme të pikturimit. Faza më e hershme shtrihet drejt lindjes, në hapësirën mbi Hijeroren. Gjurmë të pikturës murale ruhen në pjesët e mbulesës dhe në nefet anësore, por, për fat të keq, ato paraqesin dëmtime të shumta që kërkojnë ndërhyrje të ngutshme restaurimi.





Gjurmë të pikturës murale ruhen në pjesët e mbulesës dhe në nefet anësore, por, për fat të keq, ato paraqesin dëmtime të shumta që kërkojnë ndërhyrje të ngutshme restaurimi.



Në pjesën perëndimore të kishës zhvillohet narteksi, një ndërtim i mëvonshëm, që luante gjithashtu edhe funksionet e gjinekonitit. Narteksi është i hapur, i ndarë në nefe nëpërmjet shtyllave të dyfishta dhe bashkohet me kishën, si vazhdim i saj. Në murin perëndimor të kishës dallohet qartë hapja e hyrjes fillestare. Kohët e fundit janë bërë ndërhyrje për të forcuar strukturën mbajtëse të ndërtesës dhe është rindërtuar plotësisht çatia e mbuluar me rrasa guri.



Në interierin e kishës bashkëjetojnë faza të ndryshme të pikturës murale dhe plotësime të programit ikonografik. Faza më e vjetër, siç u përmend më lart, është ruajtur në pjesën e Hijerores. Absida qendrore dhe dy absidat anësore të saj janë pikturuar me skena dhe personazhe nga Dhiata e Vjetër dhe e Re. Faza më e vonë e pikturës murale i takon fillimit të shek. XX, fragmente të së cilës ruhen në muret perimetrike jashtë Hijerores, në kupolën e neft qendror dhe në shtyllat e narteksit.

Nga dekorimet e gdhendura në dru, ikonostasi është objekti më i vjetër i ruajtur në kishë. Mbishkrimet e ikonave të Shën Nikollës dhe të Fjetjes së Hyjlindëses përmendin datën 1827 dhe na njoftojnë se prarimi i ikonostasit dhe përgatitja e ikonave të tij është bërë nga ikonografët “prej Sudene”.

Afër kishës ndodhen Varrezat “Mbulesa e Shenjtë” e ushtarëve grekë të rënë në Luftën e Dytë Botërore, si dhe një mbishkrim guri i vitit 1777, si shenjë përkujtimore e vizitës së Shën Kozmait të Etolisë në zonë. Së fundi, Bularati mund të shërbejë si pikënisje pelegrinazhi drejt vendeve të tilla interesante, siç është Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses në vendin e quajtur Driano, midis Bularatit dhe Zervatit.



BIBLIOGRAFIA:

Anastasi, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Ringritja e Kishës Orthodhokse Autqefale të Shqipërisë (1991–2012). Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, 2015.


Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2005 (botuar, gjithashtu, në anglisht dhe greqisht).

Thomo P., Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1998: 152-154.

Γεώργιος Γ. Καλυβόπουλος, Χρήστος Γ. Καλυβόπουλος, Μπουλιαράτι Δερόπολη. Ιστορία - Λαϊκός Πολιτισμός, Αθήνα 1975.

Μπαρᾶς Β., Δέλβινο τῆς Βορείου Ἠπείρου καί οἱ γειτονικές του περιοχές. (Επιμέλεια Λ. Βρανούση) Ἀθῆναι, 1966.

Τα Πανάρχαια Ελληνικά Χωριά του Νομού Αργυροκάστρου. Ιωάννινα: Σύνδεσμος συνταξιούχων ελληνοδασκάλων ελληνικής εθνικής μειονότητας νομού Αργυροκάστρου, 2009.





Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses Mari, Kosinë

(Kishë Bizantine e Shek. XII)

Kosina është një vendbanim historik pranë qytetit të Përmetit. Ajo shtrihet në pjesën e sipërme të luginës së Vjosës, pranë njërit prej parqeve më të rëndësishme kombëtare në vend, “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”. Vendbanimi ndodhet rreth 35 kilometra nga pika e kalimit kufitar grek të Merxhanit (Tri Urat), në fund të fushës së Konicës dhe në distancë të njëjtë nga Manastiri i Shenjtë i Shën Marisë Molivdhoskepastit. Në zonën më të gjerë ekziston një prani e konfirmuar vendbanimesh që nga periudha e Antikitetit, të tilla si Bylisi, Apolonia dhe Amantia, qytete antike të ndërtuara në pjesën e poshtme të lumit Vjosa, gjatë rrjedhës së tij me derdhje në Adriatik.

Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses ndodhet në skajin jugperëndimor të fshatit Kosinë, në një pozicion të dukshëm, mbi kodër, i rrethuar me mur të ulët guri. Nga kompleksi i manastirit sot ekziston vetëm kisha qendrore (katholikoni), e cila, me arkitekturën saj të mrekullueshme, përbën një shembull të vogël të madhështisë së dikurshme të manastirit. Sipas burimeve historike dhe dëshmime gojore, manastiri ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shpirtërore dhe shoqërore të zonës. Gjatë periudhës së pushtimit osman, në qoshen e tij veriperëndimore ka funksionuar një shkollë në greqisht, deri në mes të viteve 1930.







Kisha e Fjetjes së Hyjlindëses, ndërtim i shek. XII-XIII, dikur ka qenë kisha qendrore e manastirit, që, siç u përmend më lart, nuk ekziston më. Ajo është e tipit në formë kryqi të brendashkruar me kupolë, me muraturë me gurë të qarkuar me tulla, me dekoracione me qeramikë, me çati në shumë nivele të mbuluar me tjegulla të kuqe qeramike dhe me dekoracione të dhëmbëzuara në brezin e kupolës. Nga pikëpamja arkitektonike, ajo paraqet elemente të ngjashme me kishën e Lindjes së Hyjlindëses në Peshkëpinë e Sipërme të Dropullit, por me dekoracione të jashtme më të pasura.



Hyrja në kishë bëhet përmes një dere në anën perëndimore, ndërsa dy dyert anësore të nefit tërthor, përkatësisht në veri dhe në jug, përdoren vetëm për ajrimin e brendshëm. Narteksi, që zhvillohet në anën perëndimore, nga jashtë duket si një nef i parme i tërthortë, që shkon paralel me nefin tërthor të naosit. Ndryshe nga çatia dyujëse e naosit, narteksi është i mbuluar me qemer cilindrik, një element që nuk haset shpesh në ndërtesa të ngjashme të së njëjtës periudhë dhe i jep karakter mjaft interesant kësaj ndërtese relativisht të vogël.

Hapësira e brendshme qendrore e kishës dominohet nga lartësia e boshtit vertikal të kupolës, nga ku hyn drita përmes katër dritareve të harkuara, të vendosura përkarshi në timbanin e saj. Fillimisht, kupola mbështetej mbi katër kolona, të cilat më pas u kthyen në shtylla masive. Brenda së njëjtës logjikë, me qëllim balancimin e peshës së përgjithshme të ndërtesës, muri në anën perëndimore të naosit u përforcua, duke përfutur trashësi më të madhe se pjesa tjetër.

Në anën lindore gjendet absida trefaqëshe e Hijerores, me harkada të verbra në të dyja faqet anësore. Në faqen qendrore ekziston një dritare karakteristike, e cila ka formë të dyfishtë. Nga brenda, ajo ka pamjen e një dritareje me një harkadë, ndërsa në anën e jashtme ka pamjen e një dritareje dylobëshe, me kolonën e zakonshme ndarëse në mes.

Në interiorin e kishës ruhen fragmente të pikturës murale, të realizuara në periudha të ndryshme kohore. Të paktën dy faza të ndryshme pikturimi janë të dukshme. Më e vjetra gjendet në absidën e Hijerores, në të cilën paraqiten hierarkët e shenjtë mbi vendin ku tradicionalisht vendoset sinthroni. Paraqitja e Krishtit Pantokrator në kupolën e kishës dhe katër Ungjillorët në trekëndëshat sferikë i përkasin një periudhe të mëvonshme.

Gjatë viteve të ndryshimeve politike dhe pas vitit 1967, megjithëse kisha ishte shpallur monument kulture që nga viti 1963, ajo u braktis dhe u shkatërrua gradualisht. Për këtë arsye, gjatë viteve 1996-1998 u kryen ndërhyrje të rëndësishme për të ndaluar dëmtimin e mëtejshëm dhe rehabilitimin e kishës. Punimet e plota të restaurimit përfunduan në vitin 2018, me mbikëqyrjen dhe financimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe miratimin përkatës të Ministrisë së Kulturës.

Οι εργασίες
αναστύλωσης τόσο
στο εξωτερικό όσο
και στο εσωτερικό
μέρος της εκκλησίας
ολοκληρώθηκαν το έτος
2018, υπό την επίβλεψη
και τη χρηματοδότηση
της Ορθόδοξης Εκκλησίας
της Αλβανίας και με τη
σχετική έγκριση του
Υπουργείου Πολιτισμού.




BIBLIOGRAFIA:

Anastasi, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Ringritja e Kishës Orthodhokse Autqefale të Shqipërisë (1991–2012). Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, 2015.

Meksi A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV). Tiranë: Uegen, 2004.

Rembeci, Andi. (editor-in-chief), *Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2015. Vol 2: Holy Metropolis of Gjirokastra*, Tirana: Ngjallja Publishers, 2015. (Published also in Albanian and Greek).

Βοκοτόπουλος, Παν., *Η εκκλησιαστική αρχιτεκτονική εις την Δυτικήν Στερεάν Ελλάδα και την Ήπειρον από του τέλους του 7ου μέχρι του τέλους του 10ου αιώνας*. Θεσσαλονίκη: Κέντρον Βυζαντινών Ερευνών, 1975.





Manastiri i Shën Gjergjit, Demë

Manastiri i Shën Gjergjit ndodhet në zonën e gadishullit të Ksamilit, përballë ishullit të Korfuzit. I vendosur në jug të qytetit të Sarandës, në hapësirën që shtrihet nga vendbanimi i Çukës deri në Detin Jon, manastiri dikur ishte ndërtesa e vetme në zonë. Me kalimin e kohës dhe zhvillimin urban të tri dekadave të fundit, zona ka ndryshuar ndjeshëm formë dhe karakter.

Gjetjet arkeologjike në zonë dëshmojnë për ekzistencën e një muri antik, ndoshta pjesë e sistemit fortifikues të qytetit antik të Butrintit, që ndodhet në distancë relativisht të shkurtër. Nuk përjashtohet mundësia që muri të kishte kullë dhe të përfundonte në një port të vogël në det, prej nga vjen dhe emri i vendit Dema (lidhje, ankorim).





Manastiri i Shën Gjergjit përmendet në burimet historike që në shek. XVII. Disa prej tyre i referohen donacioneve bujare të manastirit për realizimin e veprave publike, siç ishte ndërtimi i shkollave. Gjithashtu, nga përshtypjet e lëna me shkrim të udhëtarëve, gjejmë informacione për gjendjen dhe veprimtarinë e manastirit gjatë periudhës osmane, si dhe për mënyrën e komunikimit me zonën e prapatokës. Një vend të veçantë mes tyre zë përshkrimi i arkeologut anglez N. G. L. Hammond, i cili e vizitoi manastirin në vitin 1936, si pjesë e studimeve të tij për periudhën antike të zonës.

Manastiri rrethohet me mur të lartë guri, tek i cili janë hapur shumë frëngji për mbrojtje. Përveç kishës, brenda oborrit ekzistojnë edhe ndërtesa të tjera, si godina e igumenit në këndin juglindor. Kjo është një ndërtesë dykatëshe, dy nivelet e së cilës komunikojnë me një shkallë të jashtme guri në anën perëndimore. Karshi godinës së igumenit, në anën jugperëndimore të oborrit ndodhet një ndërtesë e gjatë dykatëshe, në formë këndore. Bëhet fjalë për godinën që i shërbente nevojave të komunitetit të murgjve dhe strehonte trapezarinë, qelitë e murgjve dhe disa dhoma për pelegrinët. Në qoshen veriperëndimore të kishës ekziston një rezervuar nëntokësor uji, i cili furnizohet përmes një sistemi original për mbledhjen e ujit të shiut nga çatia e kishës. Brenda dhe jashtë manastirit ka gjurmë të dukshme të godinave të tjera të rrënuara.

Manastiri rrethohet
me mur të lartë guri,
tek i cili janë hapur
shumë frëngji për
mbrojtje.





Si në të gjitha manastiret orthodhokse, ndërtesa kryesore është kisha ose ndryshe katedralja e manastirit, i cili i kushtohet Shën Gjergjit. Kisha përbëhet nga dy pjesë, kisha kryesore (naosi) dhe narteksti, një hapësirë e gjerë, e shtruar më vonë në anën perëndimore. Muret perimetrike të kishës janë ndërtuar ekskluzivisht me gurë dhe çatia është e mbuluar me rrasa guri të zonës. Kambanorja lartësohet mbi murin perëndimor të narteksit. Ajo është shtesë e mëvonshme, e ndërtuar me gurë gëlqerorë të zonës me të njëjtën teknikë si pjesa tjetër e ndërtesës.

Kur hyjmë në kishë, fillimisht përshkojmë narteksin e thjeshtë dhe të gjerë. Nga aty, përmes një hyrjeje relativisht të ngushtë dhe të harkuar të murit lindor, drejtohem për në zonën e naosit. Naosi është një hapësirë thuajse katrore që kufizohet me Hijeroren në lindje nga një ikonostas i ndërtuar muri, i cili komunikon me pjesën tjetër të hapësirës me tri porta harkore. Në thellimet e vogla të fasadës së ikonostasit ekziston skena e madhe e Deisis, për fat të keq, me dëmtime të shumta. Skena përbëhet nga dymbëdhjetë Apostujt, të cilët janë vendosur në të majtë dhe të djathtë të figurës qendrore të Krishtit, të ndarë në dy grupe me nga gjashtë.



Piktura murale e kishës, aty ku ka shpëtuar,
është dëmtuar rëndë dhe,
me gjithë punimet e restaurimit,
fytyrat dhe kompozimet e skenave nuk dallohen qartë.

Në qendër të naosit lartësohet kupola, me veçori arkitekture mjaft interesante. Plani i tamburit të kupolës, në pjesën e jashtme ka formën e një strukture të mysët dhjetëfaqëshe, ndërsa nga brenda zhvillohet në lartësi me tri nivele. Nëse qëndrojmë poshtë kupolës dhe shikojmë drejt saj, do të dallojmë dy rombe të njëpasnjëshme që formohen nga alternimi gradual i trekëndëshave sferikë dhe konkave të vogla. Këto rombe kanë brinjë të mysëta nga brenda dhe përfundojnë në sipërfaqen e harkuar të kupolës, ku tradicionalisht pikturohet paraqitja e Krishtit Pantokrator. Në këtë mënyrë, krijohen sipërfaqe interesante për pikturimin e personazheve të Dhiatës së Vjetër, engjëjve, gjashtëkrahëshve etj. Në nivelin e fundit më të lartë, katër vrima të ngushta, të vendosura karshi njëra-tjetrës, ndihmojnë në ajrosjen e brendshme të kishës dhe lejojnë hyrjen e rrezeve të diellit, të cilat krijojnë një kryq drite.

Piktura murale e kishës, aty ku ka shpëtuar, është dëmtuar rëndë dhe, me gjithë punimet e restaurimit, fytyrat dhe kompozimet e skenave nuk dallohen qartë.





Në vitet e regjimit ateist, manastiri ishte shndërruar në bazë ushtarake për ruajtjen e zonës kufitare detare dhe mbrojtjen ajrore. Pas punimeve të plota restauruese, të kryera nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 2006-2010, manastiri është kthyer në gjendjen e tij të dikurshme dhe sot është një vend i rëndësishëm pelegrinazhi.



BIBLIOGRAFIA:

Hammond, G. L. Nicholas. Ἡπειρος. Η γεωγραφία, τα αρχαία ερείπια, η ιστορία και η τοπογραφία της Ηπείρου και των παρακειμένων χωρών. Τομ. Α, Β, Γ. Αθήνα: Ηπειρωτική Βιβλιοθήκη, 1971.

Hodges, Richard. *Butrinti i përjetshëm, një qendër e trashëgimisë botërore të UNESCO-s*. Tiranë: Toena, 2011.


Philippson, Alfred. *Thessalien und Epirus, Reisen und Forschungen im nördlichen Griechenland*, von Dr. Alfred Philippson. Berlin: W.H. Köhl, 1897

Rembeci, Andi. (editor-in-chief), *Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2015*. Vol 2: Holy Metropolis of Gjirokastra, Tirana: Ngjallja Publishers, 2015. (Published also in Albanian and Greek).

Restaurimi i monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2005 (botuar, gjithashtu, në anglisht dhe greqisht).

Thomo P., *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut*, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1998: 152-154.

Μπαρᾶς Β., *Δέλβινο τῆς Βορείου Ἡπείρου καί οἱ γειτονικές του περιοχές*. (Επιμέλεια Λ. Βρανούση) Ἀθῆναι, 1966.





Monumentet e rajonit të Korçës



Manastiri i Apostujve të Shenjtë Petro dhe Pavli, Vithkuq



Vithkuqi ndodhet njëzet kilometra në jugperëndim të qytetit të Korçës dhe në jug të Voskopojës fqinje. I ndërtuar në një lartësi prej 1300 m mbi nivelin e detit, manastiri rrethohet nga male të larta, të cilat krijojnë një peizazh të bukur natyror dhe piktoresk.

Historia e Vithkuqit zë fill që nga periudha bizantine. Sipas traditës, ndërtimi i kishës së parë, kushtuar Shën Athanasit, daton në vitin 1162. Vendosija e sundimit osman në Shqipërinë e Jugut në fund të shek. XV solli zhvillime të reja që prekën edhe Vithkuqin. Sulltan Bajaziti II i lëshoi si mylk, stallierit të parë dhe pushtuesit të Psamathisë, Mirahor Evel Iljaz beut, shtatë fshatra në zonën e Korçës, ndër të cilat edhe Vithkuqin.

Gjatë shek. XVII-XVIII, Vithkuqi arriti një nivel të lartë ekonomik dhe kulturor, duke ndjekur rrjedhën e shumë qendrave të njohura të kohës, si Voskopoja, Nikolica, Shipska etj. Sipas historianëve të shek. XIX, gjatë kësaj periudhe prosperiteti, vithkuqi shtrihej në njëzet e katër lagje, ndër të cilat përmendim lagjet “Dukas”, “Borishë”, “Grekas”, “Tataç”, “Kovaças”, “Rusas” etj.



Gjatë viteve kur kryepiskop i Ohrit ishte Joakimi nga Voskopoja (1719-1745), u shënua një zhvillim i madh në fushën e kulturës dhe arsimit. Përveç burimeve historike të kohës, këtë e dëshmojnë edhe kishat e zbuluara të Vithkuqit, të cilat janë ndër monumentet më përfaqësuese të artit kishtar të shek. XVIII në Ballkan. Mes rreth katërmëdhjetë kishave dhe manastireve që kanë ekzistuar në Vithkuq, një vend të veçantë zë manastiri i Apostujve të Shenjtë Petro dhe Pavli, që ruhet edhe sot.

Manastiri ngrihet në një kodër, në verilindje të Vithkuqit, pranë rrënojave të lagjes historike "Borishë". Në të shkuarën, manastiri i përkiste provincës kishtarë të administruar nga Mitropolia e Kosturit. Sipas kodikut të manastirit, të botuar nga Filaretos Vafeidis, manastiri u ndërtua gradualisht në dy faza.



Faza e parë e ndërtimit nisi në vitin 1709, pas lëshimit të fermanit përkatës sulltanor dhe me para të siguruara nga Haxhi Athanas Rimaraj, nga lagjja “Borishë” e Vithkuqit. Kryemjeshtri që ndërtoi manastirin ishte Thana Lenas, nga e njëjta lagje. Në vitin 1710, u bë inaugurimi i kishës nga mitropoliti i Kosturit, me prejardhje nga Voskopoja, Dionisi, dhe peshkopi i Prespës, Joasafi, i cili më vonë u bë kryepiskop i Ohrit. Faza e dytë nisi në vitin 1759, gjatë kohës kur igumen i manastirit ishte Niko Tarasi, me ngritjen e kishës qendrore, kushtuar Apostujve të Shenjtë Petro dhe Pavli. Kisha, e tipit bazilikë me një kupolë, u pikturua në vitin 1763 nga vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi. Në vitin 1761 u pikturua ikonostasi i kishës.



Në kompleksin e manastirit gjendet edhe kisha e varrezave kushtuar Anargjendëve të Shenjtë Kozma dhe Damian. Kisha u ngrit në vitin 1736 dhe u pikturua në vitin 1750 (18 maj), po nga vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi



Në kompleksin e manastirit gjendet edhe kisha e varrezave kushtuar Anargjendëve të Shenjtë Kozma dhe Damian. Kisha u ngrit në vitin 1736 dhe u pikturua në vitin 1750 (18 maj), po nga vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi. Sipas mbishkrimit ktitorik, kisha u ngrit në vitin 1736, në kohën kur igumen i manastirit ishte Metodi, me shpenzimet e priftit ikonom, atë Joanit nga “Ajdhonohori pranë Serres”. Kisha u pikturua në vitin 1750 (18 maj) nga piktorët korçarë Konstandin dhe Athanas Zografi, kurse shpenzimet e pikturimit i morën përsipër arkondi Siropulos nga Ajdhonohori dhe Panajot Desina nga Vithkuqi. Fakti që dy nga donatorët e ndërtimit dhe të pikturimit të kishës vinin nga Ajdhonohori i Serres, dëshmon për marrëdhëniet tregtare që banorët e zonës së gjerë të Voskopojes kishin me zonën e Serres.



Nga kompleksi i manastirit sot ruhet kisha qendrore e Apostujve Petro dhe Pavli dhe kisha e Anargjendëve Kozma e Damian, që ndodhet jashtë murit të manastirit. Godinat e tjera dhe konakët u shkatërruan gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Vithkuqi u dogj nga italianët (1943). Në atë kohë u dogjën edhe katër nga kishat e mbetura të Vithkuqit, kisha e Shën Nikollës, Shën Athanasit që ishte më e vjetra, Shën Joanit dhe e Shën Parashqevisë.

Nga kishat e vjetra që kanë mbetur në Vithkuq përmendim kishën e Shën Marisë, që daton në gjysmën e dytë të shek. XVII; kishën e Shën Minait, të shek. XVIII; kishën e Ungjillëzimit të Hyjlindëses, të shek. XVIII; kishën e Shën Gjergjit, të gjysmës së dytë të shek. XVIII, një periudhë që përkon me zgjerimin urbanistik të Vithkuqit, ku secila lagje kishte dhe kishën e vet.



BIBLIOGRAFIA:

Pécharre A. A., "L'archevêché d'Ochrida de 1394 a 1767, A propos d'un ouvrage récent", *Échos d'Orient* 35 (1936): 183-323.

Rembeci, A., Çunga S., "The townlet Vithkuq of Moschopolis: cradle of the first inhabitants of Kozani as referred by the oral tradition". In: Chariton Karanasios, Basiliki Diafa-Kampouridou (eds.), *Kozani and its surrounding during the Byzantine and Modern History. Proceedings of the 3rd International Conference of Local History of Kozani*. Kozani, 7-9 December, 2018. Kozani: Western Macedonian Studies Society, 2019, 103-132.

Rembeci Andi, *The Codex of the Holy Metropolis of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)*, Master's thesis in Greek, Ionian University 2009.

Drakopoulou Eugénie, «Inscriptions della ville de Kastoria (Macédoine) du 16e au 18e siècle: tradition et adaptation». In: *Revue des études byzantines* 63 (2005): pp. 5-40.

Gelzer H., «Der Patriarchat von Achrida. Geschichte und Urkunden», in: *Abhandlungen der Philologisch-Historischen Klasse der Königlich-Sächsischen Gesellschafter Wissenschaften*, vol. 20, no. 5, Leipzig Teubner 1902: 94, 97-98, 102-103, 106, 108-111, 143.

Papakozma, A., "Manastiri i shën Pjetrit dhe Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit", *Monumentet* 1 (1983), 77–85.

Petraq Pepo, «Katër dekrete (fermane) të Sulltan Bajazitit II për Mirahor Iliaz Beun», *Studime Historike* 3 (1967): 217-238.

Petraq Pepo, «Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë. Berati i Bajazitit II dhe Vakëfnameje e mirahorlliaz beut», *Buletin për Shkencat Shoqërore* 3 (1956): 271-272.

Pirro Thomo, "Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe freskat e tyre në skenat e Apokalipsit", *Buletin i Universitetit Shtetëtor të Tiranës*, ser. *Shkencat Shoqërore* 1 (1959): 25-26.

Pirro Thomo, *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë*, 1998, 44-56.

Rousseva Ralitsa, "Iconographic characteristics of the Churches in Moschopolis and Vithkuqi", *Μακεδονικά* 35 (2006): 163-164.

Popa Theofan, *Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë*, 1998.

Tsigaras G.C., "The Painters Constantine and Athanasios from Korçë and their Work on Mount Athos", in: *2000 Years Church Art and Culture in Albania, Papers of the International Symposium*, Tirana, 16-18 November 2000, Tirana, 2005.

Γεώργιος Τσιγαράς, *Οι ζωγράφοι Κωνσταντίνος και Αθανάσιος: το έργο τους στο Άγιον Όρος (1752-1783)*. PhD dissertation, Aristoteleio University of Thessaloniki (ΑΠΘ) 1998. DOI 10.12681/eadd/10349

Γεώργιος Τσίλινς, «Τρία έγγραφα των αρχών του ΙΘ΄ αιώνα που περιέχουν στατιστικές ειδήσεις και άλλες πληροφορίες για τις επαρχίες Πρεβέζας, Μπερατίου, Μετσόβου και Κορυτσάς», Ηπειρωτικό Ημερολόγιο 14 (1992), 425-429.

Ίωακείμ Μαρτινιανος, Συμβολαί εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπολεως – Α΄, Ἡ Ἱερά Μονή τοῦ Τιμίου Προδρόμου κατὰ τὸν ἐν αὐτῇ κώδικα, 1630 - 1875. Ἀθῆναι, 1939.


Ἰωάννης Λαμπρίδης, Περί τῶν ἐν Ἡπείρῳ Ἀγαθοεργημάτων, μέρ. Α΄, Ἐν Ἀθήναις: Τύποις Γεωργίου Κιούση, 1880.

Κωνσταντῖνος Σκενδέρης, Ἱστορία τῆς Ἀρχαίας καὶ συγχρόνου Μοσχοπόλεως..., Ἀθήνα 21928, 90.

Παναγιώτης Αραβαντινός, Χρονογραφία τῆς Ἡπείρου τῶν τέ ὁμόρων ἑλληνικῶν καὶ ἰλλυρικῶν χωρῶν, τόμ. 2, Ἐν Ἀθήναις, τυπ. Σ. Κ. Βλαστοῦ, 1856.

Φιλάρετος Βαφείδης, «Κώδιξ τῆς Ἱερᾶς Μητροπόλεως Καστοριάς καὶ τινὰ ἐκκλησιαστικὰ βιβλία ἀποκείμενα ἐντισι τῶν ἐκκλησιῶν αὐτῆς», Ἐκκλησιαστικὴ Ἀλήθεια 24 (1900), 318–319.

Φιλάρετος Βαφείδης, «Περὶ τῶν ἐν τῇ ἐπαρχίᾳ Καστορίας ἱερῶν μονῶν», Ἐκκλησιαστικὴ Ἀλήθεια 20 (1900), 316-320.





Manastiri i Fjetjes së Hyjlindës Mari në Boboshticë, Korçë



Fshati Boboshticë ndodhet rreth 10 kilometra në jug të qytetit të Korçës. Është i njohur për pasuritë natyrore, thesaret historike dhe kulturore, kuzhinën tradicionale, produktet bujqësore, si dhe për kishat e tij të shumta e të bukura.

Manastiri i Fjetjes së Hyjlindës ngrihet mbi një kodër, në skajin jugor të rrugës kryesore të fshatit. Data e saktë e ndërtimit të manastirit nuk dihet, por ka të ngjarë që në këtë zonë të ketë pasur një manastir me një prani rreth njëshekullore. Nga manastiri i vjetër kishte mbijetuar një godinë e vogël me qelitë e murgjve dhe kisha e thjeshtë e tipit bazilikal njënefësh. Gjatë periudhës së persekutimit ateist, godina e qelive u përdor si depo, ndërsa kisha si stallë bagëtish.



Sipas burimeve historike, kisha e vjetër kishte dy faza ndërtimi. Faza e hershme përfshinte absidën e hijerores dhe një pjesë të murit verior, rreth 1.5 metra të lartë. Më vonë, mbi elementet ekzistuese u ndërtuan muret perimetrike dhe kisha u mbulua me çati trijeshë me një strehë të vogël në hyrjen perëndimore. Kisha nuk kishte elemente të veçanta arkitektonike dhe ishte tejte e amortizuar. Ndërtimi i mureve të fazës së dytë ishte i dobët dhe paraqiste dëmtime serioze në elementet mbajtëse të çatisë, të cilat rrezikonin shembjen e ndërtesës.

Manastiri i Fjetjes së Hyjlindësës Mari ishte një nga vendet e para ku rinisi adhurimi fetar pas rënies së regjimit komunist në vitin 1990. Për t'i dhënë jetë manastirit, në vitin 2005 dhe 2006, godina e amortizuar e qelive u shemb dhe në vend të saj u ngrit një ndërtesë e re katërkatëshe, me të njëjtin funksion. Godina e re përmban një kishë të vogël për kryerjen e shërbesave të përditshme, mjediset e mikpritjes (arkondariki) dhe akomodimit, si dhe hapësira për instalimin e pajisjeve mekanike.

Në vitin 2014, kisha e vjetër u shkatërrua, por absida e hijerores u ruajt, për t'u integruar në godinën e kishës së re qendrore të manastirit. Ndërtimi i kishës së re përfundoi në vitin 2019. Kisha e re është e tipit me çati në formë kryqi me kupolë, me kampanore të sheshtë mbi murin perëndimor dhe hajat perimetrik, ana veriore e të cilit përfundon në absidën e hijerores së kishës së vjetër. Rrethimi i oborrit të manastirit është bërë me mur guri. Pranë portës hyrëse të manastirit lartësohet kulla e pavarur e kampanores, me lartësi 12 metra. Zonat e mbjella me pemë rreth perimetrit të kompleksit i përkasin manastirit dhe janë zhvilluar si një oborr i jashtëm i rrethuar përtej oborrit të brendshëm.

Në ditën e kremtimit të Fjetjes së Hyjlindësës Mari, më 15 Gusht, në manastir organizohet një panair i madh festiv tradicional, me pjesëmarrjen e shumë besimtarëve nga i gjithë vendi.

Manastiri i Fjetjes
së Hyjlindësës Mari
ishte një nga
vendet e para
ku rinisi adhurimi
fetar pas rënies
së regjimit
komunist
në vitin 1990




BIBLIOGRAFIA:

Ἀναστασίου (Γιαννουλάτου), Ἀρχιεπισκόπου Ἀλβανίας, Ἡ ανασύσταση τῆς Ὁρθοδόξου Αυτοκεφάλου Ἐκκλησίας τῆς Ἀλβανίας 1991-2012. Συνοπτική ἀναφορά, Γ΄ ἐπαυξημένη ἔκδοση, Τίρανα: Ὁρθόδοξος Αὐτοκέφαλος Ἐκκλησία τῆς Ἀλβανίας, 2015.

Rembeci A. (editor-in-chief), Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2017. Vol 3: Holy Metropolis of Korça, Tirana: Ngjallja Publishers, 2018. (Published also in Albanian and Greek).

Forest J., The Resurrection of the Church of Albania. Geneva: WCC, 2002.

Hoppe Lyn., Resurrection. The Orthodox Autocephalous Church of Albania 1991-2003. Tirana: Ngjallja publisher, 2004.





Kisha e Lindjes së Hyjlindëses Mari Brenda një Guve Shkëmbore, në Ishullin e Maligradit, në Liqenin e Prespës së Madhe



Liqeni i Prespës ndodhet 853 m mbi nivelin e detit dhe është i rrethuar nga malet Pireneje, mali Baba (Varnounta) dhe mali i Ivanit (Libaniskos). Përbëhet nga Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël, të cilat komunikojnë ndërmjet tyre përmes një kanali të ngushtë.

Rajoni i liqeneve të Prespës, i cili është i ndarë midis Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë Veriore, është një zonë e mbrojtur ndërkufitare, e themeluar më 2 shkurt të vitit 2000, me një Deklaratë të përbashkët të kryeministrave të të tri vendeve fqinje. Rajoni përbën një park natyror shumë të rëndësishëm, për shkak të biodiversitetit dhe specieve endemike të pranishme në të. Në të njëjtën kohë, zona e Prespës është e pasur edhe me monumente historike.




Dekorimi i brendshëm dhe i jashtëm i kishës është jashtëzakonisht interesant. Nga faza e parë (1344/5), ruhet një pjesë e vogël e afreskut në murin lindor dhe në pjesët e poshtme të murit verior dhe jugor



Përgjatë brigjeve të liqenit dhe të hinterlandit ekzistojnë vendbanime, kisha dhe manastire të periudhës prehistorike dhe mesjetare, si dhe guva shkëmbore me kisha të vogla bizantine, të cilat janë dekoruar në interiorin e tyre me afreske të mrekullueshme. Këto shpella eremitësh vetmitarë në brigjet e Prespës datojnë nga gjysma e shek. XIII deri në mes të shek. XVI, duke konfirmuar praninë dhe vazhdimësinë e artit bizantin dhe të monasticizmit në zonë, edhe pas rënies së Kostandinopojës. Në atë kohë, zona e Prespës varej drejtpërdrejt nga kryepiskopata e Ohrit, një qendër e rëndësishme kishtarë e kohës, dhe ishte në kontakt me atelie të rëndësishme të artit të shek. XIV.

Kisha e Lindjes së Hyjlindëses është ndërtuar brenda një shpelle të madhe në ishullin shkëmbor dhe të pabanuar të Maligradit, në liqenin e Prespës së Madhe, pranë fshatit Pustec. Kisha është e tipit bazilikal njënefësh, me përmasa të vogla dhe e mbuluar nga një qemer gjysmëcilindrik. Sipas mbishkrimeve të ruajtura ktitorike, kisha është ndërtuar dhe pikturuar fillimisht në vitin 1344/5 nga Bojko dhe gruaja e tij, Evdhokia, së bashku me fëmijët e tyre.





Në fazën fillestare të ndërtimit, kisha ishte një bazilikë njëqëfëshe, me çati të ulët. Në vitin 1368/9, gjatë sundimit të mbretit serb Vukashin, kisha u rinovua dhe u pikturua nga sundimtarit i rajonit, Qesar Novaku. Gjatë rinovimit kisha u bë më e gjatë, çatia prej druri u zëvendësua nga një qemer gjysmëcilindrik dhe u pikturua brenda dhe jashtë.

Dekorimi i brendshëm dhe i jashtëm i kishës është jashtëzakonisht interesant. Nga faza e parë (1344/5), ruhet një pjesë e vogël e afreskut në murin lindor dhe në pjesët e poshtme të murit verior dhe jugor. Piktura murale e fazës së parë shquhet për karakterin e saj kaligrafik dhe dekorativ, karakteristikat e rrepta të portreteve dhe ngjyrat e përmbajtura. Piktura murale e fazës së dytë (1368/9) mbulon pjesën tjetër të brendshme të kishës dhe shtrihet në dy zona në murin lindor dhe në tri në atë jugor, perëndimor e verior. Në fasadën perëndimore është realizuar një nga skenat më tërheqëse, ku ndërtuesi ktitor Qesar Novaku shfaqet krah gruas së tij, Kalisë, vajzës Maria dhe djalit Amiral. I njëjti hegjemon duket se ndeshet edhe në kishën bizantine të Ristozit, në Mborje të Korçës, e ndërtuar nga episkopi i Devollit, Nifoni, në vitin 1390.



Piktura murale e fazës së dytë, për sa i përket gjallërisë së kompozimeve, lëvizjes së fytyrave, ekspresivitetit të portreteve dhe dendësisë së ngjyrave, konsiderohet si shembull tipik i shkollës së artit të Rilindjes së Paleologëve të shek. XIII-XIV. Sipas vërtetimeve të prof. E. Tsigaridas, skenat e kishës së Maligradit i përkasin së njëjtës traditë ikonografike të monumenteve që janë pikturuar nga atelietë e Selanikut, të periudhës së parë të Paleologëve, me tema dhe tipare stilistike të përvetësuara nga artistët e atelieve të Kosturit gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV dhe gjysmës së parë të shek. XV. Ateleja që ka pikturuar afresket e kishës në Maligrad, duket se është e njëjtë me atë që ka punuar në kishën e Ristozit në Mborje (1390), si dhe në kishën e Shën Athanasit në qytetin e Kosturit, e cila u ndërtua në vitin 1383/84.



BIBLIOGRAFIA:

Popa Th., Icones et miniatures du Moyen Âge en Albanie, Tirane, 1998.

Meksi A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shek. VII-XV), UEGEN, Tiranë, 2004.


Καζαζάκη Ζωή (επιμ.), Δρόμοι του ορθόδοξου μοναχισμού. Μοναστήρια της Εγνατίας Οδού. Τόμ. 1: Πολιτιστικός οδηγός - Ήπειρος, Δυτική Μακεδονία και Νότια Αλβανία, έκδ. Υπουργείο Πολιτισμού, Αθήνα, 1999.

Πελεκανίδης Μ. Στυλιανός, , Βυζαντινά και μεταβυζαντινά μνημεία της Πρέσπας. Θεσσαλονίκη : Εταιρεία Μακεδονικών Σπουδών, Θεσσαλονίκη, 1960.

Τσιγαρίδας Ευθ., Καστοριά. Κέντρο ζωγραφικής την εποχή των Παλαιοβυζαντινών (1360-1450), Θεσσαλονίκη: Εταιρεία Μακεδονικών Σπουδών, Θεσσαλονίκη, 2016.

Dhamo Dh., “L’eglise de Notre-Dame a Maligrad”, Studia Albanica I/2 (1964): 109-119.

Thomo P., “Byzantine Monuments on Great Prespa”, in: Byzantine Macedonia: art, architecture, music and hagiography. Papers from the Melbourne Conference, July 1995, ed. J. Burke, R. Scott, Melbourne 2001, 104–106, 216–223, fig. 232–250.





Kisha e Shën Kollit (Nikollës), Voskopojë



Voskopoja është një qendër e rëndësishme historike, kulturore dhe turistike. Shquhet për monumentet e saj arkitekturore, peizazhin piktoresk dhe klimën e jashtëzakonshme. Ndodhet në një pllajë, rreth 1200 m mbi nivelin e detit, midis maleve të Oparit dhe Ostrovicës. Në lindje, kodrat zbresin butë dhe formojnë një luginë, e cila është hyrja e vetme natyrore për në Voskopojë. Vendi është i pasur me pyje, kullota dhe burime ujore.



E themeluar që në shek. XIV, Voskopoja përjetoi në fillim të shek. XVIII një zhvillim të mahnitshëm ekonomik dhe shpirtëror. Akademia e Re (1744), Biblioteka dhe Shtypshkronja e saj, e para në Ballkan, fituan një reputacion të madh. Ky institucion arsimor kontribuoi në përhapjen e arsimit dhe në formimin e një lëvizjeje të gjallë intelektuale. Në atë periudhë Voskopoja numëronte njëzet e dy kisha, të cilat dalloheshin për ikonostaset e tyre të praruara me gdhendje në dru, amvonët dhe fronet despotike të gdhendura në dru, hapësirat e zbukuruara të psaltëve dhe për pikturën komplekse murale, elemente këto që i jenin madhështi të padiskutueshme dhe njëkohësisht reflektonin pasurinë dhe fuqinë e qytetit.

Deri në vitin 1670, Voskopoja varej drejtpërdrejt nga Kryepiskopata e Ohrit, më pas ajo hyri nën juridiksionin kishtar të Mitropolisë së Korçës. Në fillim të shek. XVIII, qyteti kishte katërmëdhjetë lagje dhe shtrihej në një sipërfaqe prej 1800 hektarësh. Komplekset e institucioneve fetare përbënin bërthamën e lagjeve.





Deri në vitin 1670, Voskopoja varej drejtpërdrejt nga Kryepiskopata e Ohrit, më pas ajo hyri nën juridiksionin kishtar të Mitropolisë së Korçës



Pavarësisht nga lulëzimi i saj, shoqëria e Voskopojës nuk mundi të reagoje ndaj shkatërrimeve të viteve 1769, 1772 dhe 1780 dhe, si rrjedhim, nuk arriti të rifitonte nivelin e zhvillimit që kishte më parë. Qindra familje voskopojare u detyruan të emigronin në Korçë, Janinë, Manastir, Ohër, Budapest, Vjenë dhe qendrat e tjera urbane.

Kisha e Shën Kollit (Nikollës) është një nga kishat më të mrekullueshme të Voskopojës. U ndërtua në vitin 1721 në lagjen "Rue". Nga ana arkitektonike, i përket tipit bazilikal me tri nefe, me përmasa të brendshme 19.7 x 11 m. Përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati në anën jugore. Narteksi, me formë trapezoidale, ka në pjesën qendrore një seri kolonash, të cilat lidhen me njëra-tjetrën dhe me muret perimetrike me anën e një sistemi harqesh, duke formuar ndarje drejtkëndëshe që mbulohen me qemerë gjysmë cilindrikë. Hajati, i cili shtrihet në të gjithë anën jugore të kishës, është i hapur dhe mbështetet mbi një harkadë kolonash të ulëta prej guri. Kulla e kambanores ngrihet në anën juglindore, mbi portën hyrëse të oborrit të kishës. Në oborrin e kishës ekzistonin edhe ndërtesa të tjera, si kisha e Shën Efthimit dhe qelitë që i shërbenin nevojave të manastirit, të cilat u shkatërruan nga zjarri i madh që ra në vitin 1916.

Muratura e kishës është ndërtuar me kujdes, me gurë të latuar të lidhur me suva dhe me fugatura elegante. Sipërfaqja e sheshtë e muraturës theksohet në anën lindore nga harkadat e verbra të absidës, kulmi i sipërm i të cilave përshkohet nga një kornizë dekorative me tulla në trajtën e kurrizit të peshkut. Ndryshe nga kisha, muratura e hajatit paraqet një dekorim të pasur, të realizuar përmes kombinimit të tullave dhe gurëve dhe të përdorimit të motiveve të larmishme, kornizave dhe shiritave.

Hajati është pikturuar në vitin 1750 nga vëllezërit
korçarë Kostandin dhe Athanas, të cilët,
për shkak të profesionit të tyre,
morën mbiemrin Zografi





Sipas mbishkrimeve ktitorike, kisha është pikturuar në vitin 1726 nga David Selenica, me ndihmën e Kostandinit dhe Kristos. David Selenica është i njohur për veprimtarinë e tij në Malin Athos, Kostur, Selanik e gjetkë. Hajati është pikturuar në vitin 1750 nga vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas, të cilët, për shkak të profesionit të tyre, morën mbiemrin Zografi. Gjatë dyzet viteve të veprimtarisë së tyre, vëllezërit Zografi fituan reputacion të madh, gjë që dëshmohet edhe nga fakti se ata u thirrën për të pikturuar disa prej monumenteve më të rëndësishme të kohës së tyre.





Në të djathtë të hyrjes jugore ruhet e pikturuar scena e dhurimit të kishës, ku ndërtuesi voskopojar Haxhi Jorgji ia ofron kishën Shën Nikollës që qëndron në fron, teksa mbishkrimi shkruan «Zot, desha të ndernjurit e shtëpisë sate, dhe mos e humb shpirtin tim bashkë me të pabesët». Faza e parë e pikturimit të kishës u realizua në kohën kur Kryepiskop i Ohrit dhe njëherësh Mitropolit i Korçës ishte Joasafi, një hierark i shquar dhe i ditur nga Korça. Faza e dytë u përfundua në kohën e Mitropolitit të Korçës, Nikiforit.

Ikonostasi i gdhendur në dru, i kishës së Shën Kollit të Voskopojës, ruhet sot në kishën homonime të fshatit Vlasti, në prefekturën e Kozanit. Thuhet se ai u transportua në zonë, pas shkatërrimit të qytetit, në vitin 1769, nga prifti Jorgji Sina.



BIBLIOGRAFIA:


Thomo P., Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1998, σσ. 57-61.

Rembeci A., "The codex of the Metropolis of Korça and Selasphorus (17th-19th centuries): Information about the culture in Korça area", Monumentet 52 (2011-2014), ed. Institute of Monuments of Culture, pp. 109-112.

Μαρτινιανός Ι., Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχόπολεως. Ἡ Ἱερὰ Μονὴ τοῦ Τιμίου Προδρόμου κατὰ τὸν ἐν αὐτῷ κώδικα (1630-1875), ἔκδ. Δημοτρίου Δημοτράκου, Ἀθήνα, 1939.

Μαρτινιανός Ι., Ἡ Μοσχόπολις 1330-1930, ἐν Θεσσαλονίκη, 1957.

Μοσχόπολις, Διεθνές Συμπόσιο, Θεσσαλονίκη 31 Ὀκτ.-1 Νοεμβρ. 1996, ἐκδ. Εταιρείας Μακεδονικῶν Σπουδῶν - Μακεδονικὴ Βιβλιοθήκη, ἀρ. 91, Θεσσαλονίκη, 1999.





Kisha e Re Katedrale "Ngjallja e Krishtit", Korçë

Qyteti i Korçës është qendra urbane më e populluar e Shqipërisë juglindore. Shtrihet në rrëzë të malit të Moravës, rreth 850 m mbi nivelin e detit, pranë luginës me të njëjtin emër, e cila është një nga më të pasurat dhe më të rëndësishmet në këtë zonë.

Dëshmitë e para historike në lidhje me vendbanimin e zonës së Korçës zënë fill që nga periudha bizantine. Sipas burimeve të shkruara, Korça përmendet si një qytet i lidhur me familjen feudale të Muzakajve (shek. XIII-XV), ardhur nga malësitë e Oparit dhe të vendosur në Berat, në fushën e Myzeqesë. Me pushtimin osman, provincat e Korçës, Kolonjës dhe Përmetit u organizuan në një njësi të veçantë administrative me qendër Korçën. Sipas regjistrimit të parë të administratës osmane të viteve 1431-1432, Korça shfaqet si një kështjellë me njëzet e gjashtë shtëpi, të gjitha të krishtera dhe me tregun e saj.



Gjatë periudhës para shek. XI dhe deri në vitin 1030, zona e Korçës nga ana kishtare varej prej Mitropolisë së Kosturit, siç dëshmohet nga diploma e artë (Krisovula) e perandorit bizantin Vasili II. Nga ana tjetër, Mitropolia e Kosturit i përkiste juridiksionit kishtar të Kryepiskopatës së Ohrit. Data e saktë e themelimit të Mitropolisë së Korçës nuk është e konfirmuar historikisht, megjithatë është e njohur se përmendja e parë e saj me titullin “Selasforit dhe Korçës”, është bërë pas vitit 1557.

Elementi i krishterë orthodhoks përbënte 2/3 e popullsisë së qytetit. Ai ishte i organizuar në komunitet dhe drejtohej nga Dhimojerondia (kryepiqësia) e përbërë prej dhjetë anëtarësh nga paria e qytetit. Jeta kulturore manifestohej në institucionet shpirtërore të qytetit, më e rëndësishmja prej të cilave ishte kisha e vjetër metropolitane e Burimit Jetëdhënës, e cila ndodhej brenda zonës së shkollave të komunitetit dhe ndërtesës së Mitropolisë.

Kisha e vjetër katedrale e Korçës “Burimi Jetëdhënës”, gjatë regjimit ateist u kthye në muze, pasi më parë iu shemb pjesa e sipërme e kishës, kupola dhe kampanoret. Këtu u mbledhën ikonat dhe objektet kishtare që arritën të shpëtonin pas prishjes së kishave në Jugun e Shqipërisë. Me rikthimin e lirisë së besimit dhe përmbysjen e regjimit ateist, salla e madhe në katin e parë të muzeut u përshtat për të funksionuar nga viti 1992 përsëri si tempull i lutjes, duke mbuluar nevojat kishtare të të krishterëve orthodhoksë.





Data e saktë e themelimit të Mitropolisë së Korçës nuk është e konfirmuar historikisht, megjithatë është e njohur se përmendja e parë e saj me titullin “Selasforit dhe Korçës”, është bërë pas vitit 1557.

Më pas, me kërkesë të orthodhoksëve të Korçës, filluan përpjekjet për të gjetur një tokë të përshtatshme për ndërtimin e kishës së re katedrale të qytetit. Pas shumë peripecish dhe vështirësish, falë këmbënguljes dinamike të orthodhoksëve korçarë, autoritetet shtetërore dhanë një truall me sipërfaqe të konsiderueshme në qendër të qytetit.

Më 2 gusht të vitit 1994, Kryepiskopi Anastas vendosi gurin e themelit për ndërtimin e Katedrales së re “Ngjallja e Krishtit”, e cila do të plotësonte boshllëkun e madh që la prishja e shumë kishave në këtë qytet me tradita të shquara orthodhokse. Ajo u projektua nga arkitekti Dhimitër Kristidhi nga Selaniku, ndërsa fondet për ndërtimin e saj u siguruan tërësisht nga Kryepiskopi Anastas, i cili deklaroi në atë kohë vështirësish, se “Kur na gjuajnë me gurë, ne i mbledhim ata për të ndërtuar”.

Kisha katedrale i përket tipit në formë kryqi me kupolë, disponon katër absida dhe është e rrethuar me hajat. Në dy qoshtet perëndimore lartësohen dy kambanore me nga pesë kambana secila. Nga jashtë, katedralja është e veshur me gurë dhe tulla dekorative. Në katin e nëndheshëm ndodhet një kishë, pagëzimorja, salla për veprimtari të ndryshme etj. Kisha katedrale është e pajisur me ikonostas të gdhendur artistikisht në dru. Me kontributin e besimtarëve po përfundon ikonografia në të gjithë sipërfaqen e brendshme të Kishës.

Kjo vepër madhështore u shenjtërua më 7 gusht të vitit 2004 nga Kryepiskopi Anastas, me pjesëmarrjen e Hirësisë së Tij, Ignatit, Mitropolit i Beratit; Hirësisë së Tij, Joanit, Mitropolit i Korçës dhe Hirësisë së Tij, Theoklitit, Mitropolit i Follorinës.




BIBLIOGRAFIA:

Ἀναστασίου (Γιαννουλάτου), Ἀρχιεπισκόπου Ἀλβανίας, *Ἡ ἀνασύσταση τῆς Ὁρθοδόξου Αυτοκεφάλου Ἐκκλησίας τῆς Ἀλβανίας 1991-2012*. Συνοπτική ἀναφορά, Γ΄ ἐπαυξημένη ἔκδοση, Τίρανα: Ὁρθόδοξος Αὐτοκέφαλος Ἐκκλησία τῆς Ἀλβανίας, 2015.

Forest J., *The Resurrection of the Church of Albania*. Geneva: WCC, 2002.

Hoppe Lyn., Resurrection. *The Orthodox Autocephalous Church of Albania 1991-2003*. Tirana: Ngjallja publisher, 2004.

Rembeci A. (editor-in-chief), *Construction work of the Orthodox Autocephalous Church of Albania during the years 1992-2017*. Vol 3: Holy Metropolis of Korça, Tirana: Ngjallja Publishers, 2018. (Published also in Albanian and Greek).



Partnerët e Projektit


Greqia

1. Universiteti i Janinës / Komiteti i Kërkimeve
Departamenti i Arsimit Fillor (Partner Udhëheqës)
2. Rajoni i Epirit
3. Mitropolia e Shenjtë e Janinës

Shqipëria

1. Mitropolia e Shenjtë e Gjirokastrës
2. Mitropolia e Shenjtë e Korçës
3. Bashkia Gjirokastrër

Buxheti i përgjithshëm i projektit: 635.516,32 €



Mëso më shumë:



<https://prosfora.project.uoi.gr/>

The Project is co-funded by the European Union and by National Funds of Greece & Albania



The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Union, the participating countries and the Managing Authority